Për të marrë pjesë në PQH qeveritë duhet të demonstrojnë angazhim për qeverisjen e hapur duke plotësuar kriteret minimale në dimensionet bazë të qeverisjes së hapur. Indikatorë të hartuar nga palë të treta përdoren për të vlerësuar progresin e vendit në secilin prej dimensioneve. Për më shumë informacion vizitoni <http://www.opengovpartnership.org/eligibility> ose seksionin IX për kërkesat e pranimit, të dhënë në fund të këtij raporti.



Gjergji Vurmo është hulumtues i pavarur në Shqipëri. Ai ka një përvojë 15-vjeçare pune me organizatat e sektorit të tretë në fushat e qeverisjes së mirë, integritetit evropian, zhvillimit të shoqërisë civile, dhe menaxhimit të organizatave.



Partneriteti i Qeverisë së Hapur (PQH) synon të sigurojë angazhime të qeverive ndaj qytetarëve për të promovuar transparencën, fuqizimin e qytetarëve, luftën ndaj korrupsionit, dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Shqipëria filloi të marrë pjesë në PQH në Shtator 2011. Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) vlerëson hartimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për të nxitur dialogun mes aktorëve kryesorë dhe për të përmirësuar kërkesën e llogarisë.

I. PJESEMARRJA KOMBËTARE NË PQH

HISTORIKU I PJESEMARRJES NË PQH

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (PQH) është një nismë vullnetare ndërkombëtare dhe multi-partnerësh e cila synon të sigurojë angazhime konkrete nga qeveritë për qytetarët e vet për të promovuar transparencë, të fuqizojë qytetarët, të luftojë korrupsionin dhe të nxitë përdorimin e teknologjive të reja për të konsoliduar qeverisjen. Në funksion të këtyre qëllimeve, PQH ofron një forum ndërkombëtar dialogu dhe ndarje përvojë mes qeverive, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe sektorit privat të cilët kontribuojnë në një përpjekje të përbashkët për qeverisje të hapur.

Shqipëria filloi zyrtarisht procesin e anëtarësimit në PQH në Gusht 2011 kur Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (MITIK) z. Genc Pollo shpalli synimin e qeverisë për anëtarësim. (Lidhja me letrën: <http://bit.ly/1PbFgMh>).

Për të marrë pjesë në PQH qeveritë duhet të shfaqin angazhim të provuar ndaj qeverisjes së hapur duke përbushur një sërë kriteresh minimale të performancës në lidhje me dimensionet thelbësore të qeverisjes së hapur të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për rritjen e reagimit të qeverisë, forcimit të angazhimit qytetar dhe për luftën kundër korrupsionit. Treguesit objektivë të hartuar nga organizata të tjera jashtë PQH përdoren për të vlerësuar nivelin e progresit të vendit për secilin dimension. Shih Seksionin IX: Kërkesat e Përputhshmërisë për më shumë hollësi.

Të gjitha qeveritë pjesëmarrëse në PQH duhet të hartojnë plane kombëtare veprimi të PQH të cilat të shtjellojnë angazhimet konkrete për një periudhë fillestare prej dy vitesh. Planet e veprimit duhet të përcaktojnë angazhimet PQH për secilën qeveri, të cilat zgjerojnë praktikën e qeverisë përtej stadi aktual në kuadër të sfidës madhore përkatëse. Këto angazhime mund të bazohen tek përpjekjet aktuale, të identifikojnë hapa të reja për të përfunduar reformat e papërfunduara, ose të nxisin veprim në fusha krejtësisht të reja.

Shqipëria hartoi planin e saj të dytë kombëtar të veprimit

nga janari në qershor 2014. Periudha efektive e zbatimit të planit të veprimit të dorëzuar në qershor ishte zyrtarisht 1 korrik 2014 deri në 30 qershor 2016. Ky raport i periudhës afatmesme mbulon vitin e parë të zbatimit të kësaj periudhe, 1 korrik 2014 deri në 30 qershor 2015. Raporti i vetë-vlerësimit të qeverisë u botua në 13 tetor 2015, duke lejuar një periudhë dy javore për komentet nga publiku.

Në përbushje të kërkesave të PQH, Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) i PQH bashkëpunoi me një ekspert vendor të pavarur dhe me eksperiencë, Gjergji Vurmo nga Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, i cili realizoi një vlerësim të hartimit dhe zbatimit të planit të dytë të veprimit të Shqipërisë. Qëllimi i MRP është të informojë dialogun e vazhdueshëm mbi hartimin dhe zbatimin e angazhimeve të ardhshme në secilin vend pjesëmarrës në PQH. Metodrat dhe burimet shtjellohen në shtojcën metodologjike të këtij raporti.

KONTEKSTI BAZË INSTITUCIONAL

Edhe pse konteksti institucional i PQH në Shqipëri është përmirësuar, çështjet bazë të kapacitetit, stabilitetit dhe mandatit për t'u konsultuar me shoqërinë civile kanë kufizuar ndikimin e PQH dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile.

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) drejton zyrën përgjegjëse zbatimin e angazhimeve të Shqipërisë për PQH 2014-2016. Në qeverinë e re të formuar pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2013, MIAP zëvendësoi Ministrinë për Inovacionin, Informacionin dhe Teknologjinë e Komunikimit të kabinetit të mëparshëm (Këshilli i Ministrave) dhe mori rolin e Koordinatorit Kombëtar për PQH Shqipëri. Ministri i Shtetit që është Koordinator Kombëtar i PQH ka burime të kufizuara njerëzore ndërsa financimi i tij planifikohet me buxhetin e zyrës së Kryeministrit, gjë që nuk është kështu me ministrinë "e zakonshme". Si rezultat, koordinator PQH ka burime të kufizuara dhe pak staf.

Grupi Ndërmintor i Punës dhe grupi Teknik i Punës të krijuar nga qeveria e mëparshme u zëvendësuan në shkurt 2014.¹

Bazuar në Urdhri e Kryeministrit, Nr. 37 (5 shkurt 2015) MIAP krijoi Grupin Teknik të Punës (GTP) me përfaqësues (d.m.th., ekspertë, specialistë, drejtorë) të propozuar nga secili institucion pjesëmarrës. Sekretariati Teknik, i përbërë nga përfaqësues të MIAP dhe AKSHI-t, ka ofruar mbështetje teknike për Grupin Ndërmintor të Punës për PQH dhe ka vepruar si pikë kontakti për bashkërendimin dhe raportimin e progresit.

Takimi i parë i GNP u mbajt më 7 mars, 2014. Sipas Urdhrit të Kryeministrit, GNP përfshin të gjitha ministritë e qeverisë dhe disa agjenci qeveritare, të tilla si Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), Doganat, Inspektorati Shtetëror dhe Komisioni i Prokurimit Publik. Kjo ka kufizuar shtrirjen dhe nivelin e shkëmbimit të PQH ndërmjet të gjitha institucioneve të shtetit, jo vetëm në nivel ekzekutiv, por edhe mes degëve të tjera të pushtetit.

Edhe pse Urdhri i Kryeministrit përcakton se përfaqësues nga shoqëria civile dhe agjencive të tjera shtetërore mund të marrin pjesë në takimet e GNP, shoqëria civile nuk ka qenë e ftuar. OSHC-të nuk kanë marrë pjesë në takimet e grupeve teknike të punës dhe nuk janë organizuar takime të rregullta me OSHC-të gjatë zbatimit të planit të veprimit. Përfaqësuesit e MIAP kanë mbajtur një kanal të hapur komunikimi dhe shkëmbimi me OSHC-të e interesuara.

Mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore në MIAP kanë ndikuar në procesin PQH në Shqipëri. Përveç PQH, mandati i MIAP mbulon inovacionin dhe administratën publike, ku kjo e fundit është edhe një nga reformat më të vështira në vend.

Shoqata e Politikave për një Shoqëri të Hapur (PASOS) ka mbështetur pjesëmarrjen dhe konsultimin në vend. Një projekt rajonal i drejtuar nga PASOS, Advokim për Qeveri të Hapur, i financuar nga Bashkimi Evropian, asistoi në mënyrë të veçantë procesin e konsultimit me

shoqërinë civile.²

Me gjithë përmirësimin e procesit të konsultimit PQH për hartimin e Planit të Veprimit në krahasim me vitin e parë (2012-13), kufizimet e MIAP, përfshirë ato që rrjedhin nga pozita e tij si Ministër Shteti, nuk kanë bërë të mundur një sistem të plotë institucional për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e PQH.

SHËNIME METODOLOGJIKE

MRP bashkëpunon me ekspertë kombëtarë të pavarur dhe me përvojë për të hartuar dhe shpërndarë raportin për secilën qeveri pjesëmarrëse. Në Shqipëri, MRP bashkëpunoi me Gjergji Vurmon, i cili shqyrtoi raportin e vetë-vlerësimit të qeverisë, mblodhi mendimet e shoqërisë civile dhe intervistoi zyrtarët përkatës të qeverisë dhe aktorët e tjerë. Raporti u shqyrtua nga stafi i PQH dhe një panel ekspertësh.

Ky raport mbulon vitin e parë të zbatimit të planit të dytë të veprimit të Shqipërisë, nga 1 qershor 2014 deri në 30 qershor 2015. Raporti pason një shqyrtim të mëparshëm të performancës së PQH, "Raporti i Progresit i Shqipërisë 2012-2013", që mbuloi hartimin e planit të parë të veprimit si dhe zbatimin nga 1 qershor 2012 deri në 30 qershor 2013.

Për të mbledhur mendimin e aktorëve të shumtë, hulumtuesi i MRP organizoi forumin e aktorëve të interesuar, që u mbajt sipas një modeli me fokus grupe. Hulumtuesi MRP për Shqipërinë shqyrtoi edhe dy dokumente kryesore të përgatitura nga qeveria: një raport për planin e dytë të qeverisë³ dhe një vetë-vlerësim të botuar nga qeveria në tetor 2015.⁴ Këto dokumente janë referuar herë pas here në të gjithë raportin. Në shtojcën e këtij raporti jepen përmbledhje të këtyre forumeve dhe shpjegime më të hollësishme.

¹ Urdhri Nr. 37 i Kryeministrit, datë 5 shkurt 2015, "Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit të partneritetit për qeverinë e hapur 2014-16".

² Advokim për qeveri të hapur: Hartimi i agjendës së shoqërisë civile dhe monitorimi i planeve të veprimit të vendit, marrë nga bit.ly/1RvZZPp

³ Qeveria e Shqipërisë, Plani i Dytë Kombëtar i Veprimit PQH 2014-16, marrë nga bit.ly/1ZQte2a. 4 Vetë-vlerësimi Afatmësëm i Shqipërisë, 13 tetor 2015, marrë nga bit.ly/1RmcXB5

⁴ Vetë-vlerësimi Afatmësëm i Shqipërisë, 13 tetor 2015, marrë nga bit.ly/1RmcXB5

II. PROCESI: HARTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Procesi i hartimit të Planit të dytë Kombëtar të Veprimit PQH (2014-16) ishte më përfshirës sesa ai i planit të parë (2012-13). Bashkëpunimi mes grupeve të shoqërisë civile dhe të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) është përmirësuar. Megjithatë, konsultimet dhe veprimet e informimit mbetën të përqendruara në kryeqytet. Përfshirja e institucioneve shtetërore kufizohej vetëm tek qeveria qendrore dhe tek pak agjenci brenda Ekzekutivit. Disa rekomandime të shoqërisë civile u morën parasysh nga MIAP.

Vendet që marrin pjesë në PQH ndjekin një proces konsultimi gjatë hartimit të planit të veprimit PQH. Sipas neneve për Qeverisjen të PQH, vendet duhet:

- Të publikojnë paraprakisht (minimalisht online) detajet e procesit të konsultimit publik dhe kalendarin para konsultimeve
- Të konsultojnë gjerësisht komunitetin kombëtar, përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat; të identifikojnë një mori qëndrimesh të ndryshme dhe; të bëjnë publike online një përmbledhje të konsultimit publik dhe të gjithë komentete individuale me shkrim
- Të ndërmarrin aktivitete ndërgjegjësuese për PQH për të përmirësuar pjesëmarrjen publike në konsultime

- Të konsultojnë popullatën me njoftim paraprak të mjaftueshëm dhe nëpërmjet mekanizmave, përfshirë ato online dhe takimeve vetëm për vetëm, për të siguruar akses tek mundësitë për përfshirjen e qytetarëve.

Në rregullat e PQH për qeverisjen përcaktohet edhe një kërkesë e pestë gjatë konsultimeve. Kjo kërkesë shtjellohet në seksionin "III: Konsultimi gjatë zbatimit":

- Vendet anëtare duhet të identifikojnë një forum për të mundësuar konsultime të rregullta për një sërë aktorësh mbi zbatimin e PQH. Ky mund të jetë një forum ekzistues ose një strukturë e re.

Kjo adresohet në seksionin e mëposhëm, por evidenca për konsultimet para dhe gjatë zbatimit janë përfshirë këtu dhe në Tabelën 1 për referencë.

Tabela 1: Listë verifikimi për procesin e hartimit

FAZA E PLANIT TË VEPRIMIT	KËRKESA E PROCESIT PQH (NENET E SEKSIONIT TË QEVERISJES)	A E PËRMBUSHI QEVERIA KËTË KËRKESË?
Gjatë hartimit	A ishin të disponueshëm kalendarin dhe procesin para konsultimit?	Jo
	A ishte kalendarin i disponueshëm në internet?	Po
	A ishte kalendarin i disponueshëm në kanale të tjera?	Jo
	Jepni adresën e kalendarit.	http://bit.ly/1TESrtu
	A bëheshin njoftime paraprake për konsultimin?	Po
	Sa ditë më parë jepej njoftimi?	17

PHASE OF ACTION PLAN	OGP PROCESS REQUIREMENT (ARTICLES OF GOVERNANCE SECTION)	DID THE GOVERNMENT MEET THIS REQUIREMENT?
During Development	A ishte njoftimi i përshtatshëm?	Jo (shih shpjegimin)
	A kreu qeveria aktivitete ndërgjegjësimi?	Jo
	A u bënë konsultimet online?	Po
	Vendosni adresën e konsultimeve.	bit.ly/1CJic7z bit.ly/1gDxSiJ
	A u bënë konsultime me kontakte të drejtpërdrejta?	Po
	A u dha ndonjë përmbledhje e komenteve?	Po
	Vendosni adresën e komenteve.	bit.ly/1O6IW1L
	A ishin konsultimet e hapura apo vetëm me ftesë?	Të hapura
	Vendosni konsultimet në spektrin IAP2. ¹	Konsultim
Gjatë zbatimit	A kishte forum të rregullt për konsultime gjatë zbatimit?	Jo
	A ishin konsultimet e hapura apo vetëm me ftesë?	N/A
	Vendosni konsultimet në spektrin IAP2.	N/A

NJOFTIMI PARAPRAK DHE NDËRGJEGJËSIMI

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) publikoi një ftesë për konsultime publike në faqen e vet më 11 prill, 2014. Palët e interesuara mund të paraqisnin komentet e tyre deri më 28 prill 2014 (me njoftim paraprak 17 ditësh). Megjithatë, konsultimet kishte filluar një muaj më parë, në mars, me iniciativën e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Ky i fundit kishte qarkulluar një ftesë për OSHC-të në Shqipëri për të marrë pjesë në konsultimet në një konferencë kombëtare më 28 mars, e cila u bashkërendua me MIAP dhe aktorë të tjerë si PASOS, Koalicioni OSHC-ve për PQH Shqipërinë, Delegacionit të BE-së, ambasada

amerikane në Tiranë, dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (PNUD).

MIAP ka përdorur gjerësisht aktiviteteve promovuese të kryera nga Koalicioni OSHC për OGP Shqipëri.² Koalicioni u krijua më 5 dhjetor 2013, në një konferencë të organizuar së bashku me MIAP, ku u mbledhën organizata të shoqërisë civile, qeveria, donatorë dhe aktorë të tjerë të angazhuar për të përmirësuar procesin PQH Shqipëri.³ Konferenca u mbajt në kuadër të "Advokimin për Qeveri të Hapur: Vendosja e agjendës dhe monitorim i plan veprimeve kombëtare nga ana e shoqërisë civile", një projekt i PASOS i financuar nga BE-për të inkurajuar qeveritë në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mali të Zi dhe Serbi

të bëhen më transparente. Koalicioni OShC i krijuar nga ky projekt ka inkurajuar dhe përkrahur Koordinatorin Kombëtar PQH të Shqipërisë (MIAP) për të zgjeruar konsultimet e PV. Nga i njëjti projekt, më 28 mars 2014 u bashkë-organizua një konferencë kombëtare me MIAP, ku aktorët shqiptarë u prezantuan me përvojën PQH të vendeve të Ballkanit Perëndimor.⁴ Shoqëria civile dhe përfaqësuesit nga qeveria diskutuan angazhimet e mundshme për PQH Shqipërinë. OShC-të shqiptare i paraqitën një listë me 25 propozime MIAP. Përveç rekomandimeve të Konferencës së marsit, MIAP kishte marrë komente për planin e ri të veprimit deri në fillim të qershorit 2014.

Nuk u organizuan fushata ndërgjegjësimi nga MIAP apo OShC-të.

THELLËSIA DHE SHTRIRJA E KONSULTIMEVE

Në krahasim me ciklin e planit të mëparshëm të veprimit, procesi i hartimit të planit të dytë PQH për vendin kishte përmirësime të konsiderueshme. Shoqëria civile mori rolin drejtues në kryerjen e konsultimeve me pjesëmarrje për planin e veprimit.

Koordinatori Kombëtar PQH, MIAP, ishte shumë bashkëpunues me aktorët e shoqërisë civile dhe koalicionin e saj për PQH Shqipëri. MIAP iu përgjigj ftesës së koalicionit për bashkë-organizimin e konferencës në 28 mars 2014 si forum për konsultime me OShC dhe për marrjen e përvojës nga rajoni. Përfaqësues nga agjencitë shtetërore ishin pjesëmarrës aktiv në këtë aktivitet. Po ashtu, MIAP nisi një konsultim online dhe organizoi një takim tjetër konsultimi në 28 prill 2014 me OShC shqiptare. Gjatë periudhës prill-qershor 2014, në mjediset e MIAP u organizuan takime individuale me OShC dhe përfaqësues të Koalicionit të OShC-së. MIAP ka botuar përmbledhje të takimeve konsultative dhe 25 rekomandimet e paraqitura nga OShC.⁵ Megjithatë, nuk është botuar përmbledhja e paraqitjeve individuale apo e konsultimeve në person.

Procesi shfaqti disa mangësi. Takimet e konsultimit u zhvilluan vetëm në kryeqytet, në Tiranë. Sesione informuese të MIAP përfshinë vetëm agjencitë qendrore qeveritare. I vetmi takim informues dhe trajnim jashtë Tiranës u organizua nga koalicioni OShC për PQH Shqipëri me përfaqësues të shoqërisë civile dhe u zhvillua pasi ishte finalizuar Plani i Veprimit.⁶ Në Tiranë, koalicioni organizoi dy aktivitete advokimi me OShC dhe përfaqësues të qeverisë më 16 maj (për PQH në nivel vendor) dhe një tryezë të rrumbullakët PQH me titullin, "Rritja e Komunikimit mes Policisë dhe Komunitetit", më 19 maj 2014.⁷ Pjesëmarrja e përfaqësuesve të sektorit private në këto takime konsultative ishte e ulët.

Procesi i PQH në Shqipëri mund të përfitonte nga më shumë aktivitete ndërgjegjëse me institucionet e qeverisë qendrore dhe vendore. Përkundër pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimit të duhur të shoqërisë civile në procesin e konsultimit, OShC-të pretendojnë se Plani i miratuar i Veprimit PQH ka përfshirë jo më shumë se një angazhim për qeveritë vendore të propozuara nga OShC-të dhe një numër të kufizuar rekomandimesh lidhur me procesin, të tilla si publikimi i kalendarit të konsultimeve. Ka mosmarrëveshje për nivelin e përfshirjes së rekomandimeve të OShC-ve. Zyra e Koordinatorit Kombëtar PQH-së thotë se ka më shumë angazhime, të cilat i përgjigjen rekomandimeve të organizatave të shoqërisë civile. Koalicioni OShC për PQH Shqipëri lëshoi një deklaratë ku i bënte thirrje qeverisë të rriste kontributin e shoqërisë civile në këtë proces.⁸ Thirrje të ngjashme janë bërë me e-mail nga OShC të tjera që punojnë me çështje PQH.

¹ "Spektri IAP2 për Pjesëmarrjen Politike", International Association for Public Participation, bit.ly/1kMm1YC.

² IDM (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim) është partneri vendor i Projektit PASOS që merret me bashkërendimin e veprimtarive të projektit në Shqipëri. Marrë në tetor 2015.

³ "Koalicioni shqiptar PQH u shpall në konferencën e IDM," faqja e PASOS, marrë nga bit.ly/1RwbJkO

⁴ "Projekti PASOS jep rekomandime qeverisë shqiptare mbi qeverinë e hapur (+video)", faqja e bit.ly/1OSccsA

⁵ "Konsultimi publik," faqja MIAP, marrë nga bit.ly/1CJic7z

⁶ "Trajnim për partneritetin e qeverisë së hapur dhe shoqëria civile: Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2014-2016," dokumenti mund të shkarkohet nga adresa bit.ly/1kQhJrG

⁷ "Advokimin për Qeveri të Hapur: Vendosja e agjendës dhe monitorim i plan veprimeve kombëtare nga ana e shoqërisë civile," faqja e IDM, marrë nga bit.ly/1ITofld

⁸ "IDM i bën thirrje qeverisë shqiptare të risë kontributin e shoqërisë civile për Qeverinë e Hapur," faqja e PASOS, marrë nga bit.ly/1OdTFBn

III. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Nuk ka ende një forum të rregullt me shumë aktorë për të realizuar konsultim për zbatimin e PQH në Shqipëri. Shoqëria civile nuk u përfshi në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit të veprimit.

Si pjesë e pjesëmarrjes së tyre në PQH, qeveritë angazhohen për të identifikuar një forum për të mundësuar konsultime të rregullta me shumë aktorë të interesuar në zbatimin e PQH. Ky forum mund të jetë një organ ekzistues ose i ri. Ky seksion jep një përmbledhje pikërisht të këtij informacioni.

KONSULTIME TË RREGULLTA ME SHUMË AKTORË

Pavarësisht thirrjes së shoqërisë civile për krijimin e një forumi konsultimi me shumë aktorë për zbatimin e planit të veprimit PQH, një mekanizëm i tillë nuk është krijuar ende. Përfaqësuesit e shoqërisë civile të intervistuar nga hulumtuesi i MRP argumentojnë se mungesa e një forumi të tillë i ka mbajtur OSHC dhe aktorët e tjerë jo-shtetërorë jashtë zbatimit dhe monitorimit të planit të veprimit.

MIAP ka qenë shumë e gatshme për kontakte dhe shkëmbime me koalicionin OSHC për PQH Shqipëri gjatë vitit të fundit. Megjithatë, forumi me shumë aktorë dhe mungesa e masave të tjera, si fushata ndërgjegjësimit, informimi dhe konsultimi i aktorëve të mundshëm nga sektorë të tjerë, shqyrtimi transparent dhe procesi i raportimit do të çonin në një përjasje mjaft proaktive dhe gjithëpërfshirëse ndaj zbatimit të planit të veprimit. Përfaqësuesit e MIAP e vlerësojnë nevojën për një forum me shumë aktorë dhe për një fushatë më të gjerë ndërgjegjësimit, por kanë evidentuar burimet e kufizuara që ka zyra e Koordinatorit Kombëtar të PQH. Monitorimi dhe raportimi për zbatimin e planit të veprimit ka përfshirë vetëm institucionet shtetërore.

Hulumtuesi MRP mundi të gjente të dhëna vetëm për një takim të grupit teknik të punës (GTP) (prill 2015) dhe shkëmbime të ndryshme elektronike (shkurt deri qershor 2015) ku institucionet shtetërore kanë raportuar për zbatimin e angazhimeve. Punimet e këtyre takimeve, përfshirë përfundimet dhe hapat e mëtejshëm, nuk janë botuar ende. Disa institucione përgjegjëse për

angazhimet PQH raportojnë për shkëmbime më të shpeshta me MIAP për monitorimin e progresit, përfshirë një takim shqyrtimi në shkurt 2015 për të cilën hulumtuesit MRP nuk iu paraqitën fakte. Shpeshtësia e pakët e raportimit periodik dhe monitorimi i parregullt i zbatimit të angazhimeve përbëjnë një shqetësim serioz.

Duke pasur parasysh këto kufizime dhe mangësi, hulumtuesi MRP sugjeron përdorimin e një forumi ekzistues me shumë aktorë për të mundësuar një shqyrtim më të hapur e më gjithëpërfshirës të zbatimit të planit të veprimit. Në këtë kontekst, Këshilli Kombëtar për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile (një organ këshillimor pranë qeverisë), që pritet të krijohet në fund të 2015, mund të ishte një alternativë. Një tjetër mundësi janë takimet periodike specifike për PQH nën suazën e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, të krijuar së fundmi. Edhe pse opsioni i parë mund të jetë më i përshtatshëm për shkak të përmbajtjes (PQH si pjesë e dialogut qeveri-

OSHC), alternativa e dytë ofron përfaqësim më të mirë të aktorëve të mundshëm, sepse KKIE përfshin përfaqësues të degëve të ekzekutivit, legjislativit, e gjyqësorit, të shoqërisë civile, medias, botës akademike dhe sektorit privat.

Progresi në zbatimin e PV, kontrollet, raportimi dhe monitorimi periodik duhet të jenë më të plota dhe rezultatet e tyre të bëhen publike. Po ashtu, fushata e ndërgjegjësimit dhe informimi për PQH nuk duhet të mbështeten vetëm tek shoqëria civile. Në këtë drejtim rekomandohet përfshirja e zyrës së Kryeministrit.

IV. ANALIZA E PËRMBAJTJES SË PLANIT TË VEPRIMIT

Të gjitha vendet pjesëmarrëse në PQH hartojnë plan veprimin kombëtar të PQH, i cili shtjellon angazhime konkrete për një periudhë dy vjeçare. Qeveritë fillojnë plan veprimet kombëtare duke ndarë përpjekjet ekzistuese në lidhje me sfidat madhore që kanë zgjedhur, përfshirë strategji dhe programe ekzistuese specifike për qeverisje të hapur. Plan veprimet më tej përcaktojnë angazhimet PQH të qeverisë të cilat shtrijnë praktikën qeveritare përtej bazës aktuale në lidhje me fushën përkatëse të politikave. Këto angazhime mund të ndërtojnë mbi përpjekjet ekzistuese, të identifikojnë hapa të reja për të përfunduar reformat ekzistuese, ose të iniciojnë veprime në fusha krejtësisht të reja.

Angazhimet PQH duhet të përshtaten me rrethanat unike të secilit vend dhe interesat e politikave. Ato duhet të kenë të bëjnë me vlerat PQH të përcaktuara nga Nenet PQH të Qeverisjes dhe në Deklaratën e Qeverisë së Hapur të nënshkruar nga të gjitha vendet pjesëmarrësve. MRP përdor udhëzimin e mëposhtëm për të vlerësuar lidhjen me vlerat bazë të qeverisë së hapur:

AKSESI TEK INFORMACIONI

Angazhimet për qasjen tek informacioni:

- Lidhen me informacionin e mbajtur nga qeveria përkundër vetëm informacionit për veprimtarinë e qeverisë. Si shembull, nxjerrja e informacionit të mbajtur nga qeveria në lidhje me ndotjen do të ishte me shumë vlerë, edhe pse informacioni nuk është në vetvete "veprimtari e qeverisë";
- Nuk kufizohen vetëm tek të dhënat por kanë të bëjnë me të gjithë informacionin (p.sh., bërja publike e kontratave individuale të ndërtimit dhe nxjerrja e të dhënave për një sërë kontratash ndërtimi);
- Mund të përfshijnë nxjerrjen e informacionit tek të dhënat e hapura dhe sistemet që janë themel i publikimit të të dhënave;
- Mund të mbulojnë nxjerrjet proaktive dhe/ose reaguese të informacionit;

- Mund të mbulojnë edhe publikimin e të dhënave dhe/ose përmirësimin e lexueshmërisë teknologjike të informacionit;
- Mund të kenë të bëjnë me mekanizmat për forcimin e të drejtës së informimit (si zyra e Avokatit të Popullit)
- Duhet të ofrojnë akses të hapur tek informacioni (nuk duhet jetë i privilegjuar apo për përdorim të brendshëm vetëm për qeverinë);
- Duhet të nxisin transparencën e vendimmarrjes së qeverisë dhe përmbushjen e funksioneve bazë;
- Mund të synojë të ulë koston e marrjes së informacionit;
- Duhet të përpiqen të arrijnë 5-vje për projektimin e të dhënave të hapura (bit.ly/1ZUVBxi).

PJESËMARRJA QYTETARE

Angazhimet për pjesëmarrjen qytetare mund të kenë të bëjnë me pjesëmarrjen formale të publikut apo pjesëmarrjen më të gjerë qytetare. Këto angazhime synojnë në përgjithësi të "konsultimin", "përfshirjen", "bashkëpunimin" ose "fuqizimin", siç shpjegohet në Spektrin e Pjesëmarrjes Publike të Shoqatës Ndërkombëtare për Pjesëmarrjen Publike (bit.ly/1kMmLYC).

Angazhimet që trajtojnë pjesëmarrjen publike:

- Duhet të bëjnë publike vendimmarrjen për të gjithë anëtarët e interesuar të publikut; forume të tilla janë "nga lart-poshtë" për faktin se krijohen nga qeveria (ose organe me mbështetje të qeverisë) për të informuar vendimmarrjen gjatë gjithë ciklit të politikës);
- Mund të përfshijnë elementë të qasjes tek informacioni për të siguruar kontribut të qenësishëm të anëtarëve të interesuar të publikut tek vendimet që merren;
- Shpesh përfshijnë të drejtën për të përçuar zërin, por jo domosdoshmërisht të përfshijnë të drejtën e

pjesëmarrjes formale në procesin e vendimmarrjes.

Si alternativë, angazhimet mund të trajtojnë mjedisin e gjerë funksional që mundëson pjesëmarrjen në hapësirën qytetare. Disa shembuj të tillë janë edhe të mëposhtmet dhe jo vetëm:

- Reforma që rrisin lirinë e mbledhjes, shprehjes, petitionit, shtypit apo organizimit në shoqata
- Reforma për shoqatat përfshirë ligjet për sindikatat apo OJQ-të
- Reforma që përmirësojnë transparencën dhe proceset formale demokratike, si propozime të qytetarëve, zgjedhjet apo petitionet.

Angazhimet e mëposhtme janë shembuj të angazhimeve që mund të mos evidentohet si me lidhje të qartë me termin më të gjerë të pjesëmarrjes qytetare:

- Angazhime që supozojnë se pjesëmarrja do të rritet në sajë të botimit të informacionit pa përcaktuar mekanizmin për një pjesëmarrje të tillë (edhe pse ky angazhim do të shënjohej si “qasja tek informacioni);
- Angazhime për decentralizimin që nuk përcaktojnë mekanizmat për rritjen e pjesëmarrjes së publikut;
- Angazhime që përcaktojnë pjesëmarrjen si bashkëpunim mes agjencive pa një mekanizëm për pjesëmarrjen e publikut.

Angazhimet që mund të shënjohej si me “lidhje të paqartë” përfshijnë edhe ato mekanizma ku pjesëmarrja kufizohet tek organizatat e zgjedhura nga qeveria.

LLOGARIDHËNIA PUBLIKE

Në angazhimet që përmirësojnë llogaridhënien mund të përfshihen:

- Rregullat, rregulloret dhe mekanizmat që i bëjnë thirrje qeverisë të përligjë veprimet e veta, të veprojë ndaj kritikave apo kërkesave që i bëhen asaj dhe të pranojë përgjegjësinë për mosveprimin në përputhje me ligjet apo angazhimet.

Në përputhje me qëllimin bazë të “Qeverisë së Hapur” të llogaritur si “me lidhje të qartë”, këto angazhime duhet të përfshijnë një element të përballjes me publikun, që do të thotë se nuk janë thjesht sisteme të brendshme të llogaridhënies. Edhe pse angazhime të tilla mund të lëvdohen dhe të përmbushin sfidën e madhe të

PQH, ato, siç janë artikulluar, nuk kalojnë testin e “lidhjes së qartë” për shkak të mungesës së hapjes së tyre. Aty ku mekanizmat e përballjes me publikun janë pjesë e rëndësishme e strategjisë së qeverisë, rekomandohet që qeveria të përfshijë një element të përballjes me publikun, të tilla si:

- Publikimi i të dhënave të përgjithshme jo-sensitive (metadata) për veprimtaritë institucionale (sipas parimit të publikimit të sa më shumë të dhënave)
- Auditet qytetare të performancës;
- Procese apelimi të nisura nga qytetarët në rast të punës së dobët apo abuzimit.

Angazhimet e forta për llogaridhënien i atribuohen të drejtave, detyrave, apo pasojave për veprimet e zyrtarëve apo institucioneve. Angazhimet e përgjegjshmërisë formale përfshijnë mjetet për të shprehur zyrtarisht ankesat apo për të raportuar shkeljet dhe marrjen e dëmshpërblimit. Tek shembujt e angazhimeve të forta përfshihen:

- Përmirësimi ose krijimi i proceseve të apelimit për mohimin e marrjes së informacion;
- Përmirësimi i qasjes tek drejtësia duke bërë që mekanizmat e drejtësisë të jenë më të lira, më të shpejta e më të lehta për t’u përdorur.
- Përmirësimi i kontrollit publik për mekanizmat e drejtësisë;
- Krijimi i sistemeve publike të ndjekjes së procesit të ankesave publike (të tillë si program për ndjekjen e rastit për policinë apo linjat telefonike falas për anti-korrupsionin).

Angazhimi që pretendon se përmirëson përgjegjshmërinë, por që thjesht jep të dhëna apo informacione pa shpjeguar cilat janë mekanizmat apo ndërhyrjet që do ta përkthejnë atë informacion në pasoja apo ndryshime, nuk klasifikohet si angazhim i përgjegjshmërisë (llogaridhënies). Për më shumë informacion shih bit.ly/1oWPXdl.

TEKNOLOGJIA DHE NOVACIONI PËR HAPJEN DHE PËRGJEGJSHMËRINË

PQH synon të rrisë përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit për të mundësuar përfshirjen e publikut në qeverisje. Në mënyrë të veçantë, angazhimet që përdorin teknologjinë dhe inovacionin duhet të rrisin transparencën

dhe llogaridhënien me anë të:

- Promovimit të teknologjive të reja që ofrojnë mundësi për ndarjen e informacionit, pjesëmarrjen publike dhe bashkëpunimin.
- Publikimit të më shumë informacioneve në mënyrë që t'u bëjë të mundur njerëzve të kuptojnë atë që bën qeveria dhe të ndikojnë në vendimet e saj.
- Punës për uljen e kostove të përdorimit të këtyre teknologjive.

Po ashtu, angazhimet që do të quhen si teknologji dhe novacion:

- Mund të përfshihen në një proces që angazhon shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit për të evidentuar praktikat efikase dhe përfaqeset novatore për të mundësuar teknologjitë e reja që fuqizojnë njerëzit dhe nxisin transparencën në qeveri;
- Mund të përfshihen për të mbështetur aftësinë e qeverive dhe qytetarëve për përdorimin e teknologjisë për transparencë dhe përgjegjshmëri;
- Mund të mbështesin përdorimin e teknologjisë nga punonjësit e qeverisë dhe qytetarët.

Jo të gjitha reformat e e-qeverisjes përmirësojnë transparencën e qeverisë. Kur bëhet një angazhim për e-qeverisjen, ai duhet të shprehet qartë se si do të përmirësojë të paktën një nga të mëposhtmet: qasjen tek informacioni, pjesëmarrjen publike, apo llogaridhënien tek publiku.

VARIABLAT KRYESORË

Pranimi se përmbushja e angazhimeve të qeverisë së hapur shpesh kërkon një proces shumë vjeçar, qeveritë duhet të përcaktojnë afatet dhe standardet për angazhimet e tyre, të cilat të tregojnë se çfarë do të realizohet çdo vit, kur është e mundur. Ky raport jep detaje për secilin prej angazhimeve të vendit të përfshira në planin e veprimit dhe analizon zbatimin e tyre në vitin e parë.

Të gjithë treguesit dhe metoda e përdorur në kërkimin MRP mund të gjenden në Manualin e Procedurave MRP, tek adresa (bit.ly/1rki45i~pobj). Një masë meriton shpjegim të mëtejshëm, për shkak të interesit të saj të veçantë për lexuesit dhe dobia për nxitjen e një gare drejt kreut mes vendeve pjesëmarrëse në PQH:

“angazhimet me yje.” Angazhimet me yje konsiderohen angazhime tipike PQH . Për të marrë një yll, angazhimi duhet të plotësojë disa kritere:

1. Duhet të jetë mjaftueshmërisht i detajuar që të mundësojë gjykimin për ndikimin e mundshëm të tij. Angazhimet me yje kanë detajim “mesatare” ose të “lartë”.
2. Gjuha e angazhimit duhet të bëjë të qartë lidhjen e tij me hapjen e qeverisë. Në mënyrë specifike, ai duhet të lidhet me të paktën një nga vlerat PQH të qasjes tek informacioni, pjesëmarrjes publike, apo llogaridhënies tek publiku.
3. Angazhimi duhet të ketë Ndikim të mundshëm “transformues” nëse zbatohet plotësisht.¹
4. Së fundi, angazhimi duhet të bëjë përparim të dukshëm gjatë periudhës së zbatimit të PV, ku të zbatimi i tij të renditet si “i përfunduar” ose “i konsiderueshëm”.

Së fundi, tabelat në këtë seksion paraqesin një pjesë të pasurisë së të dhënave që ka mbledhur MRP gjatë procesit të raportimit të progresit.

VËSHTRIM I PËRERGJITHSHËM I ANGAZHIMEVE

Qeveria shqiptare ndërmori 13 angazhime në kuadër të Planit të Veprimit PQH 2014- 16. Pjesa më e madhe e angazhimeve (9 nga 13) mbështeten në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për përmirësimin e shërbimeve publike, transparencës dhe llogaridhënies.

Hartimi i Planit të Veprimit nga qeveria në fillim të vitit 2014 u udhëhoq nga vlerat e PQH, ndërsa struktura e tij ndjek logjikën e sfidave të mëdha PQH. E njëjta qasje u përdor edhe nga koalicioni i OSHC-ve për PQH Shqipëri, e cila ftoi shoqërinë civile shqiptare që të kontribuojë në hartimin e planit të dytë të veprimit të vendit. Në mënyrë të veçantë, në konferencën e 28 mars 2014 u mbajtën diskutime në panele paralele për të shtjelluar projekt angazhimet që do t'i paraqiten Qeverisë, sipas pesë sfidave madhore PQH:

- Përmirësimi i shërbimeve publike
- Rritja e integritetit publik
- Menaxhimi më efektiv i burimeve publike

- Krijimi i komuniteteve më të sigurta
- Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave

Shoqëria civile paraqiti 25 propozime, duke përfshirë jo vetëm angazhime të veçanta, por edhe rekomandime për përmirësimin e konsultimeve PQH dhe zbatimin e përgjithshëm të planeve të veprimit. Konsultimet me OShC-të u kufizuan pas prillit 2014 dhe u kryen në kryeqytet, Tiranë. Nuk u organizuan veprimtari të tjera për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të mëtejshëm.

Plani i veprimit i miratuar nga qeveria dhe i paraqitur tek PQH në korrik 2014 trajton katër (nga pesë) sfidat madhore PQH si më poshtë:

- Katër angazhime nën sfidën madhore “Rritja e integritetit publik”
- Tre angazhime nën sfidën madhore “Menaxhimi më efektiv i burimeve publike”
- Katër angazhime nën sfidën madhore “Përmirësimi i shërbimeve publike”
- Dy angazhime nën sfidën madhore “Krijimi i komuniteteve më të sigurta”.

Pjesa më e madhe e angazhimeve të planit të veprimit të Shqipërisë pasqyrojnë të paktën një nga parimet PQH: transparenca, pjesëmarrja qytetare, përgjegjshmëria, ose teknologjia dhe novacioni. Megjithatë, përdoruesi ose përfituesi përfundimtar i ndikimit të angazhimeve nuk është gjithmonë publiku i gjerë. Raporti MRP konstaton se disa angazhime fokusohen tek një audiencë e kufizuar ose relevanca e tyre me vlerat PQH mbetet e diskutueshme.

Ambicia e shumicës së angazhimeve është të prodhojnë rezultate dhe ndryshim në nivel kombëtar. Një angazhim ka për qëllim promovimin e vlerave PQH tek autoritetet e pushtetit vendor, ndërsa zbatimi i tij u shtjellua si përgjegjësi e përbashkët e koalicionit të OShC-ve për PQH Shqipëri, Ministrin të Shtetit për Çështjet Vendore, dhe Koordinatorit Kombëtar të PQH, Ministrin të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

GRUPIMI (CLUSTERING)

Raporti MRP ka riorganizuar tetë nga angazhimet e PV dhe i ka ndarë ato në katër grupe me qëllim që të bëjë të mundur të kuptohet më mirë progresi i arritur. Grupimi u bë për angazhimet që synojnë një prioritet të caktuar (p.sh., luftën kundër korrupsionit) ose ato që i përkasin një sektori (p.sh., doganat, mjedisi).

Prandaj, struktura e këtij raporti është paksa e ndryshme nga ajo e planit të veprimit dhe shtjellon pesë angazhime secili më vete dhe një tjetër tetëshe të grupuar në katër ndarje, si më poshtë:

- Denoncimi i korrupsionit
- Të dhënat e hapura dhe shërbimet elektronike (e-shërbimet)
- Qasja e hapur tek të dhënat e burimeve natyrore
- Shërbime të thjeshtësuara të doganave

¹ Paneli i ekspertëve ndërkombëtarë e ndryshoi këtë kriter në vitin 2015. Për më shumë informacion vizitoni bit.ly/1IUMUho

1.2 REGJISTRI ELEKTRONIK I LEJEVE TË ENERGJISË DHE INDUSTRIISË

Teksti i angazhimit:

Regjistri elektronik i autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve të bëra nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, në kuadrin e rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë, ka ndërmarrë nismën e Regjistrimit Elektronik, me synim krijimin dhe botimin në faqen e saj në internet të një regjistri elektronik për autorizimet, lejet, dhe marrëveshjet e dhëna në fushat përkatëse dhe statusi i tyre i përditësuar.

Aktualisht ka mungesë informacioni jo vetëm për procedurat për marrjen e një autorizimi apo lejeje, por edhe qytetarët, grupet e interesit, shoqëria civile nuk kanë informacion mbi numrin e lejeve dhe autorizimeve të dhëna në sektorin e energjisë dhe industrisë. Për të trajtuar këtë problem dhe për të siguruar transparencë

të plotë mbi gjendjen e aktorëve që veprojnë në këto fusha, Ministria ka nisur procesin e identifikimit të gjendjes aktuale, gjë do të mundësojë një proces më të lehtë monitorimi.

Ky sistem regjistri do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë së kësaj ministrie, por do t'i japë akses tek informacioni nëpërmjet regjistrimit elektronik.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Energjetikës dhe Industrisë

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
			X		X			X			X			X		

ÇFARË NDODHI?

Ky angazhim synon të krijojë një regjistër elektronik për dhënien e autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve në sektorin e energjisë dhe industrisë, duke mundësuar qasjen e publikut tek informacioni për operatorët në këtë sektor.

Krijimi i regjistrimit elektronik të koncesioneve në sektorin

e energjisë dhe industrisë përfaqëson vazhdimin e angazhimit të Shqipërisë për e-koncesionin sipas Planit të parë të Veprimit PQH 2012-13.¹ Edhe pse angazhimi në planin e veprimit të parë ishte për krijimin e një procedure elektronike koncesion pa elementin e aksesit publik, angazhimi i planit të dytë të veprimit fokusohet në transparencën dhe aksesin e publikut tek

autorizimet, lejet dhe marrëveshjet e bëra nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MIE). Angazhimi i ri është pjesërisht në përputhje me rekomandimin nr. 8 që ka propozuar shoqëria civile gjatë konsultimeve për PV (mars 2014) për të siguruar transparencë të kompanive që operojnë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri.

Si pjesë e planit të parë të veprimit, nisma e regjistrimit elektronik filloi në prill 2014 nga MIE në kuadrin e takimit të Nismës së Transparencës së Industrisë Nxjerrëse Shqipëri (EITI Albania).² Në kohën e miratimit të planit të dytë të veprimit PQH (qershor 2014), Ministria po mbledhte informacione për operatorët, autorizimet dhe lejet e dhëna dhe marrëveshjet e firmosura në fushat përkatëse.

Mungesa e detajimit të gjuhës së angazhimit për sa i përket rezultateve, afateve kohore, dhe institucionit përgjegjës e bën të vështirë ndjekjen në mënyrë të qartë të progresit të këtij angazhimi. Ligji për Koncesionet dhe Partneritetet Publike-Private (2013) përcakton se regjistri do të krijohet dhe menaxhohet nga njësi për koncesionet dhe partneritetin publik-privat në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS).³ Megjithatë, është e paqartë nëse mandati për zbatimin e këtij angazhimi është transferuar nga MIE tek MZHETTS.⁴ Raporti i vetë-vlerësimit thekson se Drejtoria e Koncesioneve në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë është përgjegjëse për zbatimin e këtij angazhimi dhe cakton afatin e projektit për 30 dhjetor 2015. Uebfaqja aktual e Agjencisë së Koncesioneve, një agjenci në varësinë e MZHETTS, nuk ka ndonjë informacion për Regjistrin e Koncesioneve.⁵ Nga MIE nuk është dhënë informacion edhe pse hulumtuesi IRM i ka dërguar tre kërkesa zyrtare për informacion me e-mail gjatë periudhës së gushtit- shtatorit 2015.

Raporti i vetë-vlerësimit të qeverisë sugjeron se ky angazhim është zbatuar pjesërisht. Sipas raportit të vetë-vlerësimit, faza fillestare e këtij projekti është përfunduar dhe Ministria është duke punuar për krijimin e Sistemit të Monitorimit dhe Informacionit të Koncesioneve. Ndryshimet në Ligjin për Koncesionet dhe Partneritetin Publik-Privat (korrik 2015) bëjnë të detyrueshme nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore që rregullojnë regjistrin elektronik, të cilat nuk janë miratuar ende.

Gjithsesi, shoqëria civile ka krijuar instrumente të dobishme për ta bërë informacion mbi kontraktorët publik. Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS), një organizatë e shoqërisë civile me qendër në Tiranë, ka krijuar një bazë të dhënash elektronike të koncesioneve në Shqipëri, duke renditur një total prej 61 kompanish private dhe koncesionet përkatëse të dhëna nga qeveria në sektorin e energjisë dhe industrisë nxjerrëse.⁶

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Krijimi i një regjistri elektronik të koncesioneve në sektorët e energjisë dhe industrisë nxjerrëse është një hap i madh përpara drejt rritjes së transparencës së këtyre sektorëve të rëndësishëm. Energjia, sidomos hidrocentralet, dhe zbulimi i mineraleve përbën një aktivitet të rëndësishëm dhe në rritje të ekonomisë shqiptare. Siç tregon edhe Raporti i vitit 2012 i Nismës së Transparencës së Industrisë Nxjerrëse Shqipëri (EITI), përqindja e PBB-së së industrisë nxjerrëse të vendit është rritur nga 2.4% në 2008 në 5.6% në vitin 2012. Sot, qindra kompani operojnë në sektorin nxjerrës që më parë ishte pronë shtetërore, dhe numri i lejeve rritet vit pas viti.

Ndikimi i mundshëm i regjistrimit varet kryesisht nga lloji i informacionit dhe të dhënave që ofron për publikun. Gjuha e angazhimit nuk përcakton llojin e informacionit duke e bërë të vështirë vlerësimin e ndikimit të mundshëm përtej mesatares. Aktorët e shoqërisë civile janë të kujdesshëm në vlerësimin e rezultateve të mundshme të këtij angazhimi jo vetëm për shkak të mungesës së përparimit në zbatimin e tij deri më tani, por edhe për shkak të përshkrimit të tij të paqartë në planin e veprimit dhe paqartësisë në lidhje me institucionin përgjegjës.⁷

RRUGA PËRPARA

Hulumtuesi MRP rekomandon hapat e mëposhtëm për të mundësuar më shumë qartësi në zbatimin e këtij angazhimi:

- Riformulimi i angazhimit me më shumë rezultate të hollësishme dhe një kalendar për regjistrin elektronik në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore. Të përfshihen module të veçanta në regjistrin elektronik për të botuar të dhëna më të hollësishme për

veprimtarinë e operatorëve ekonomikë.

- Të bashkërendohet puna me MZHETTS, Agjencinë e Koncesioneve, shoqatat e sektorit privat, kompanitë që veprojnë në sektorin e energjisë, dhe organizatat e shoqërisë civile gjatë zbatimit dhe monitorimit të këtij angazhimi. Të merren parasysh rekomandimet e OSHC për të vijuar më tej me angazhimin e 2012 për EITI dhe të zhvillohet bashkëpunimi me OSHC me përvojë për ndarjen e ekspertizës.

¹ Progres Raporti MRP 2011–13 për Shqipërinë, f. 51, marrë nga bit.ly/1ZgGdO1

² Raport nga media marrë nga bit.ly/1n8KD8q dhe bit.ly/1SEOwxP

³ Ligji Nr. 77/2015, datë 16 korrik 2015, Gazeta Zyrtare 132/2015 (faqe 6,763), marrë nga bit.ly/1POrhi6

⁴ "Fund abuzimit dhe koncesioneve monopol. Regjistri krijoi procedura të reja për vetëm 145 ditë, uebsajt i qeverisë, marrë nga bit.ly/1SEPLgV

⁵ Adresa e agjencisë për regjistrin e koncesioneve, marrë nga bit.ly/22V1w9, vizituar për herë të fundit më 28 shtator 2015

⁶ Portali i AIS për koncesionet, marrë nga bit.ly/1OXdWXP. Intervistë me Drejtoreshën e AIS, Aranita Brahaj (shtator 2015).

⁷ Intervista me OSHC mjedisore dhe grupe fokusit me aktorët kryesorë (shtator 2015).

1.4 PROMOVIMI I VLERAVE PQH TEK AUTORITETET VENDORE

Teksti i angazhimit:

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Koalicionin e shoqërisë civile për PQH do të ndërmarrin së bashku angazhimin për promovimin dhe përfshirjen e autoriteteve vendore tek vlerat PQH.

Ky angazhim u propozua nga organizatat e shoqërisë civile me qëllim prezantimin dhe promovimin e vlerave themelore të PQH edhe tek njësitë e qeverisjes vendore. Synimi është të përforcohet mekanizmi i pjesëmarrjes dhe të krijohet qeverisja e hapur edhe në

nivel vendor. Disa nga veprimet që do të ndërmerren janë veprimtari promovuese, ndryshimet ligjore për nxitjen e transparencës dhe vlerave të tjera PQH.

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Institucion(et) mbështetës(e): Koalicioni i OSHC-ve për PQH Shqipëri

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
	X				E PAQARTË				X				X			

ÇFARË NDODHI?

Siç është përshkruar në Planin e Veprimit, ky angazhim ka për qëllim promovimin e vlerave PQH tek pushteti vendor. Ashtu siç është shkruar, angazhimi përshkruan vetëm aktivitetin “për të promovuar dhe për të angazhuar autoritetet vendore në vlerat PQH,” dhe kjo nuk përfshin informacion mbi rezultate të veçanta ose ndikimin e tyre. Mund të supozohet se ky angazhim do të rezultonte në zhvillimin e veprimeve të caktuara, por gjatë periudhës që mbulohet nga ky raport, as institucioni përgjegjës as OSHC nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap. Vetë-vlerësimi i qeverisë vë në dukje se zbatimi i këtij angazhimi ka nuk ka filluar ende, pavarësisht përpjekjeve të Koalicionit të OSHC-ve për

gjenerim fondesh.

Hulumtuesi MRP thekson se Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV), MIAP dhe koalicioni OSHC janë ende të paqartë për rolet e tyre përkatëse në zbatimin e këtij angazhimi. Përfaqësuesit e të dy institucioneve shprehin mbështetjen e tyre të plotë për nisma konkrete që mund të shtjellohen më tej nga koalicioni OSHC.

Gjithsesi, ata mendojnë se duhet të jetë Koalicioni forca shtytëse e këtij angazhimi dhe jo zyra e Ministrisë.

Nga ana tjetër, përfaqësues të koalicionit sugjerojnë se janë penguar së vepruari te ky angazhim për shkak të mungesës së fondeve dhe ndarjes së re administrative-territoriale që hyri në fuqi pas zgjedhjeve të qershorit

2015.¹ Gjatë kohës që po hartohej ky raport, dy anëtarë të Koalicionit (Lëvizja Mjaft dhe IDM) konfirmuan se do të nisnin në vjeshtë të vitit 2015 zbatimin e projekteve konkrete që synojnë këtë angazhim. Të dy projektet janë me financim nga Ambasada e ShBA-ve në Tiranë. Projekti i IDM-së do të zhvillohet në dy linja: së pari, ngritja e forumit shumëpalësh në bashkëpunim me MIAP; dhe, së dyti, zbatimin e masave PQH në dy njësi të qeverisjes vendore. Projekti i Lëvizjes Mjaft do të monitorojë dhe ndihmojë bashkitë në përmirësimin e aksesit tek instrumentet e informacionit.

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Në mungesë të kuadrit konkret të masave për realizimin e këtij angazhimi, lidhja dhe ndikimi i mundshëm i PQH janë të paqartë.

Hartimi i këtij angazhimi nuk përfshinte përfaqësues të shoqatave të autoriteteve vendore dhe as njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) për të pilotuar masa specifike. MSHÇV, si pjesë e qeverisë qendrore, nuk mund të veprojë në emër të NJQV-ve. Megjithatë, ministri mund të konsultohet, të informojë dhe të inkurajojë aktorët vendorë (NJQV-të dhe shoqatat e tyre) për marrjen përsipër të angazhimeve. Ministri mund të lehtësojë edhe diskutimet me OSHC për të formuluar propozime për angazhimet përkatëse në nivel vendor.

Në përgjithësi të gjithë janë dakord për nevojën për transparencë më të madhe, pjesëmarrje më të mirë, dhe llogaridhënie në nivel vendor në Shqipëri. Për shembull, Shoqata Ndërkombëtare e Konteve dhe Bashkive (ICMA) ka caktuar prioritetet e saj për Shqipërinë, duke filluar nga mjetet e buta si kode etike deri tek indeksi i transparencës.² Raporti më i fundit i Bashkimit Evropian iu referuar qeverisjes vendore si "krejtësisht të pambrojtur nga korrupsioni." Për këtë arsye, janë më se të nevojshme veprime të mëtejshme për hapjen e qeverisjes vendore.

Drejtuës të shoqërisë civile të përfshirë në PQH i bënë jehonë nevojës për një angazhim në nivel vendor. Ideja e një angazhimi PQH që përfshin autoritetet e qeverisë vendore në procesin PQH u propozua nga organizatat e shoqërisë civile.³ Në mënyrë të veçantë, rekomandimi OSHC-ve ishte "përfshirja e institucioneve vendore në hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit. Institucionet

vendore duhet të ndërmarrin angazhime për nxitjen e qeverisjes transparente dhe gjithëpërfshirëse.⁴ "MIAP, Koordinator i Kombëtar PQH për Shqipërinë, ishte dakord me këtë rekomandim, i cili më vonë u përpunua nga Koalicioni OSHC për PQH Shqipëri. Megjithatë, pavarësisht marrëveshjes, gjuha e këtij angazhimi nuk ishte asnjëherë shumë e detajuar. Koalicioni sugjeroi masa të tilla si:

- Publikimi i vendimeve (akteve ligjore të ndërmarrura nga NJQV-të)
- Pjesëmarrja e qytetarëve në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, programeve dhe planeve vendore;
- Transparenca e buxhetit dhe aksesit tek informacioni; dhe
- Forcimi i mekanizmave për përgjegjshmërinë dhe integritetin publik.⁵

Në mungesë të masave konkrete të sugjeruara nga koalicioni OSHC, ky angazhim është kufizuar tek rritja e ndërgjegjësimi dhe informimit të NJQV-ve për PQH.

RRUGA PËRPARA

Është më se e qartë se duhet më shumë punë për hapjen e NJQV-ve në planin tjetër të veprimit PQH dhe kjo gjë në fakt mund të shtjellohet më tej edhe gjatë pjesës së mbetur të këtij plani veprimi.

Ndërhyrjet e ardhshme nga projektet e dy anëtarëve të koalicionit OSHC janë hapa të nevojshëm që mund të çojnë në përqafimin e ambicieve PQH nga më shumë NJQV dhe zbatimin e tyre në nivel vendor. Edhe këtu, për zbatimin e këtij angazhimi do të nevojitet si më poshtë:

- Më shumë përfshirje nga koalicioni dhe NJQV-të
 - o Këto përpjekje mund të përfshijnë NJQV të caktuara si institucione përgjegjëse.
- Pritshmëri, rezultate dhe ndikim të përcaktuar më mirë.
 - o Duke bërë një gjë të tillë, aktorët kryesorë duhet të lidhen edhe me strategjinë e decentralizimit të miratuar kohët e fundit, i cili i referohet PQH, si dhe legjislacionit të ardhshëm në këtë fushë.⁶
- Një synim më të qartë, qofshin instrumente ligjore,

institucionale apo të tjera rregullatore për të gjitha NJQV-të.

o Këtu mund të përfshihen disa aktivitete konkrete që synojnë një praktikë specifike më të mirë që duhet të zbatohet dhe të përhapet tek NJQV-të e tjera. Në të dy rastet, ambicia e angazhimit duhet të vendosë lidhje të qartë me një ose disa nga vlerat PQH.

¹ Intervistë me anëtarë të Koalicionit OSHC për PQH Shqipëri, Erisa Lame (IDM) dhe Aldo Merkoci (MJAFT! Movement) në shtator 2015.

² "Transparenca dhe Anti-Korrupsion," faqja zyrtare e ICMA International, marrë nga bit.ly/1W08iDG

³ "Projekti PASOS i dorëzon rekomandimet e Qeverisë së Hapur tek qeveria shqiptare," faqja e PASOS, marrë nga bit.ly/1OSccsA

⁴ Shih rekomandimin nr. 15 tek <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/10/Civil-Society-Recommendations.pdf>

⁵ Shih përfundimet e tryezës së rrumbullakët "Qeveria e Hapur" (16 maj 2014) tek <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/10/OGP-Round-Table-Open-Local-Government.doc>

⁶ VKM Nr. 691, 29 korrik 2015. Gazeta Zyrtare 147/2015.

2.1 BAZA E TË DHËNAVE PËR PËRFITUESIT E NDIHMËS EKONOMIKE

Teksti i angazhimit:

Krijimi i bazës së të dhënave për të dhënat e qeverisë për ndihmën ekonomike. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin Social Shtetëror, në kuadër të reformës për zbutjen e varfërisë, rritjen e transparencës, cilësisë së shërbimit dhe përdorimit efektiv të fondeve buxhetore dhe përjashtimin e rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike, ka ndërmarrë nismën për krijimin e Regjistrit Kombëtar Elektronik të përfituesve të ndihmës ekonomike. Administrimi i përfitimeve është penguar nga kapaciteti joadekuat, mungesa e sistemit të informacionit, mbikëqyrjes dhe kontrollit. Shqipëria aktualisht nuk ka regjistrë kombëtar elektronik të kërkuesve të ndihmës ekonomike dhe marrja e ndihmës ekonomike administrohet në nivel vendor me dokumentacionin në formë letrë. Kjo rrjedhimisht çon në (a) mungesë

efikasiteti në aplikimin dhe dhënien e përfitimeve (kostot më të larta të transaksioneve), (b) dobësitë në mbikëqyrjen dhe kontrollin për mashtrime dhe gabime, dhe (c) monitorimin dhe vlerësimin e politikave joefektive sociale. Zbatimi i sistemit të ri do të ndihmojë në përmirësimin e efektivitetit të Shërbimit Social Shtetëror duke identifikuar familjet në nevojë, do të përmirësojë vlerësimin e përfituesve nga familjet aplikante dhe do të përjashtojë rastet abuzive në skemën e ndihmës ekonomike.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Institucion(et) mbështetës(e): Shërbimi Social Shtetëror

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
			X		E PAQARTË						X				X	

ÇFARË NDODHI?

Angazhimi synon të përmirësojë efektivitetin e skemës së asistencës sociale në Shqipëri duke krijuar Regjistrin Kombëtar Elektronik të përfituesve të ndihmës ekonomike.

Regjistri Kombëtar Elektronik i Përfituesve të Ndhmës Ekonomike është pjesë e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale për Shqipërinë, një nisme e përbashkët e Bankës Botërore në Shqipëri dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Në vitin

2013 ata filluan përgatitjet për pilotimin e Regjistrimit Kombëtar Elektronik të Përfituesve të Ndhmës Ekonomike në tre rajone të Shqipërisë: Tiranë, Durrës dhe Elbasan.¹ Regjistri filloi nga puna në tre rajone në qershor të vitit 2014.² Pas përfundimit me sukses të fazës pilot deri në fund të vitit 2016, regjistri do të zbatohet në të gjithë vendin. Sistemi bën të mundur vlerësimin e aplikimeve, kontrollin dhe verifikimin, dhe vendimmarrjen dhe miratimin e pagesës elektronike të ndihmës ekonomike. Regjistri është i ndërlidhur me bazat e të dhënave të tjera të qeverisë për të vlerësuar aplikimet, të tilla si bazën e të dhënave të regjistrimit civil, sigurimet shoqërore, shërbimin shtetëror të punësimit, regjistri i pasurive të paluajtshme, qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve, e kështu me radhë. Dixhitalizimi i sistemit të ndihmës ekonomike në të gjithë regjistrin elektronik ka shërbyer për të ulur numrin e abuzimeve.³

Sipas raportit të fundit të projektit (korrik 2015) të Bankës Botërore, të paktën 80% e skedarëve të aplikantëve në regjistrin në tre rajonet pilote janë të plota dhe në përputhje me proceset e aplikimit dhe përfitimit.⁴ Projekti i Bankës Botërore është një reformë e madhe në të cilën përfshihet rishikimi i parametrevë të programeve të ndihmës ekonomike. Për zbatimin e kësaj reforme, është e nevojshme të forcohen kapacitetet e autoriteteve vendore, rajonale dhe qendrore në fushat si menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të dhënies së ndihmës ekonomike. Këto aktivitete plotësuese mbulohen nga një Projekt i Instrumentit të Para-Aderimit (Projekti IPA).⁵

Vetë-vlerësimi i Qeverisë raporton se ky angazhim është zbatuar plotësisht. Megjithatë, baza e të dhënave mund të zbatohet në nivel kombëtar vetëm nga fundi i vitit 2016. MMSR dhe Shërbimi Social Shtetëror aktualisht po monitorojnë zbatimin e sistemit në rajonet pilote, po zgjerojnë lidhjet e këtij sistemi me bazat e të dhënave të tjera qeveritare, dhe po përfshijnë module shtesë, të tilla si regjistri elektronik për personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në analizën e zbatimit të tij dhe çështjet kryesore me interes, baza e të dhënave do të jetë plotësisht funksionale në nivel kombëtar pas vitit 2016.

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Baza e të dhënave për ndihmën ekonomike është një nismë e rëndësishme e qeverisë që mund të sigurojë rritjen e efikasitetit të ndihmës financiare, të ulë barrën administrative, dhe të shkurtojë procesin e aplikimit për përfituesit. Megjithatë, sistemi është për përdorim të brendshëm të institucioneve shtetërore, dhe pavarësisht nga funksioni i saj për të gjeneruar të dhëna (d.m.th., numrin e përfituesve, burimet financiare, përqendrimi gjeografik), këto të dhëna nuk bëhen publike. Prandaj, lidhja e tij me vlerat e PQH mbetet e paqartë. Edhe pse projekti mbështetet në përdorimin e teknologjive, regjistri elektronik nuk përmban elementët që të mund ta lidhin atë me transparencën apo llogaridhënien publike. Sipas përfaqësuesit të MMSR, të dhënat e ndihmës ekonomike janë mjaft të rëndësishme për hartimin e politikave efektive sociale. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile sugjerojnë se në mungesë të një elementi të transparencës për llogaridhënie publike apo të “mekanizmit të pjesëmarrjes dhe monitorimit”, lidhja e këtij angazhimi PQH është shumë e diskutueshme.

Ndikimi i këtij projekti shtrihet edhe në fusha të tjera, si zgjedhjet, duke pasur parasysh faktin se ndihma ekonomike shpesh është keqpërdorur për qëllime elektorale.⁶ Megjithatë, në media janë raportuar disa raste të përjashtimit të padrejtë nga ndihma ekonomike gjatë vitit të kaluar.⁷ Janë ngritur edhe pyetje për kriteret ligjore për dhënien e ndihmës, përfshirë këtu edhe tek tre rajonet ku po zbatohet projekti pilot. Shoqata të ndryshme dhe grupe të shoqërisë civile i kanë kërkuar Ministrisë të bëjë vlerësimin e duhur të kërkesave, të rishikojë kriteret e dhënies, dhe të trajtojë zyrtarët publikë të cilët po zbatojnë procesin.⁸ Raporti Vjetor 2014 i Avokatit të Popullit paraqiti në total 184 ankesa individuale apo në grup në lidhje me ndihmën ekonomike, duke përpiluar edhe një rekomandim për MMSR.⁹

RRUGA PËRPARA

Hulumtuesi MRP thekson rëndësinë e objektivit të projektit. Megjithatë, përshtetja e angazhimit në planin e veprimtimit PQH dhe zbatimi i projektit duhet të harmonizohen më mirë me vlerat PQH dhe në mënyrë

më të veçantë me "Teknologjinë dhe Inovacionin për transparencë dhe llogaridhënie." Publikimi i të dhënave të prodhuara nga regjistri elektronik do të bëjë të mundur përgjegjshmëri më të madhe në këtë proces dhe si dhe do të mundësojë përfshirjen e grupeve të interesit në debate më të informuara për hartimin e politikave për mirëqenien sociale. Duke qenë se disa të dhëna për ndihmën ekonomike gjenden edhe në portalin GIS të INSTAT-it¹⁰, rekomandohet shumë që MMSR dhe Shërbimi Social Shtetëror të bashkërendohen me INSTAT-in në këtë drejtim. Ky bashkërendim duhet të jetë në përputhje me rekomandimin nr 11 të OSHC të propozuar gjatë konsultimit për planin e veprimit në 28 mars 2014.

¹ "Ndihma ekonomike," marrë nga bit.ly/1K9G0ja

² Intervistë me Zj. Jonida Cerekja, ish pikë kontakti e angazhimit në MMSR (shtator 2015).

³ Buxheti 2015 i MMSR-së: "Kemi rritur pagesat për shtresat në nevojë", adresa qeveritare në internet, marrë nga bit.ly/1mQUAHd

⁴ "Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale," adresa e Bankës Botërore në internet, marrë nga bit.ly/1W0CbDV

⁵ Fisha Nr. 11 e Projektit – Programet kombëtare IPA / Komponenti I," adresa e BE-së në internet, marrë nga bit.ly/1TQcwwt

⁶ "SHSSH padit Xhelal Mziun për abuzim me ndihmën ekonomike," Dita Gazeta, 28 janar 2014, marrë nga bit.ly/1OXJD3n. "Memoriali, qyteti ku abuzohet me ndihmën ekonomike," SHGD, 26 shtator 2013, marrë nga bit.ly/1ndMb0T.

⁷ "Totozani në Elbasan: 400 familje janë përjashtuar pa të drejtë nga skema ekonomike," Top Channel, 7 tetor 2015, marrë nga bit.ly/1Rizq1s. "Ndihma ekonomike, Avokati i Popullit: Të rikohet formula. Ka padrejtësi," ORA News, 26 dhjetor 2014, marrë nga bit.ly/1ZnZzAB. "Cërrik, protesta për ndihmën ekonomike," Top Channel, 3 shtator 2015, marrë nga bit.ly/1SKp2Pu

⁸ Intervista me Dritan Ziu (Roma Active Albania) përfaqësues të tjerë të OSHC (shtator 2015).

⁹ "Raport Vjetor Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit," 2014, fq. 81–83, marrë nga bit.ly/1RxPOLW

¹⁰ Disa të dhëna për ndihmën ekonomike gjenden tek botimet dhe faqja në internet e INSTAT <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

3.2 GJEOPORTALI KOMBËTAR

Teksti i angazhimit:

Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, në bashkëpunim me Autoritetin Shqiptar për Informacione Gjeohapësinore do të ndërmarrë krijimin e një Gjeoportali Kombëtar Elektronik, i cili, për herë të parë do t'u sigurojë qytetarëve dhe institucioneve informacion transparent dhe të saktë gjeohapësinor. Njëpërmjet hartografimit të Gjeoportali Kombëtar qytetarët dhe palët e interesuara mund të hyjnë në hartat topografike, ortofoto, harta kufitare, harta treguese të pasurive të patundshme, dhe hartat e vlerës së pronës.

Disa nga hapat që do të matin realizimin e këtij angazhimi janë: koordinimi ndërinstitucional për të mundësuar mbledhjen e të dhënave ekzistuese, përgatitja e termave të referencës për infrastrukturën me programet dhe pajisjet kompjuterike të nevojshme për realizimin e këtij angazhimi, përgatitja e modelit të të dhënave për informacioni gjeohapësinor, uebsajti paraprak i gjeoportali do të vërë në dispozicion informacionin ekzistues, përgatitja e informacionit të ri gjeohapësinor.

Informacion mbi pronën dhe vlerën e tokës, pozicionimi dhe hartat kufitare me të dhënat përkatëse janë për momentin shumë të vështirë për t'u mbledhur nga qytetarët. Po ashtu, niveli i korrupsionit në këtë fushë ka qenë shumë i lartë për një kohë të gjatë. Njëpërmjet zbatimit të këtij angazhimi do të kontribuohet në lehtësimin e qasjes tek hartat gjeohapësinore dhe tek të dhënat në një portal të vetëm.

Shënim redaksional: Angazhimi përshkruan "disa hapa" për zbatimin e tij si më poshtë:

- Bashkërendim mes agjencive për të mundësuar mbledhjen e të dhënave aktuale
- Përgatitja e termave të referencës për infrastrukturën me programet dhe pajisjet kompjuterike të nevojshme për realizimin e këtij angazhimi
- Përgatitja e modelit të të dhënave për informacioni gjeohapësinor,
- Uebsajti paraprak i gjeoportali do të vërë në dispozicion informacionin ekzistues,
- Përgatitja e informacionit të ri gjeohapësinor

Institucioni përgjegjës: Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike; Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
NË TËRËSI				X	X			X			X			X		
3.2.1 Mbledhja e të dhënave				X	X						X				X	
3.2.2 Termat e referencës për softuer dhe harduer				X	X					X				X		
3.2.3 Përgatitja e modelit të të dhënave				X	X			X			X		X			
3.2.4 Uebporti paraprak i gjeoportalit				X	X			X			X					X
3.2.5 Informacioni i ri gjeohapësino r			X		X			X			X		X			

ÇFARË NDODHI?

Angazhimi synon të ofrojë informacion transparent dhe të saktë gjeohapësino r dhe shërbimet përkatëse. Portali është zhvilluar dhe menaxhohet nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësino r (ASIG), i krijuar në vitin 2013.¹ Krijimi i gjeoportalit kombëtar është detyrim ligjor që buron nga Ligji nr. 72/2012, datë 28.06. 2012.

Në kohën e miratimit të PV të Shqipërisë për PQH (qershor 2014), Gjeoportali ishte zhvilluar tashmë në versionin beta, edhe pse popullimi i tij me të dhëna ishte ende në rrugë e sipër.² Krijimi i Gjeoportalit Kombëtar nisi në 2013 me një grant të qeverisë norvegjeze (1.2 milionë euro) dhe me mbështetje teknike të Autoritetit Norvegjez të Hartografimit.³ Në kuadër të Projektit të Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Hapësino r, asistencë që do të ofrohet gjatë 2013-2016 do të bëjë të mundur:

- Autoritetin Shqiptar të Infrastrukturës Gjeohapësino r si institucioni përgjegjës për zbatimin e direktivës INSPIRE;

- Kuadrin Shqiptar të Referencës Gjeodete si referencë e standardeve evropiane për GIS kombëtar; dhe
- Gjeoportalin Kombëtar, nëpërmjet të cilit do të aksesohen të dhënat gjeohapësino r dhe shërbimet përkatëse.

Kjo nismë synon të përfshijë edhe hartat e nevojshme për të gjithë sektorët e ekonomisë. Kjo ambicie është e ngjashme me punën që po kryhet nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), gjatë vitit të kaluar për krijimin e GIS INSTAT.⁴

Përfaqësuesi i ASIG-t i intervistuar nga hulumtuesi MRP raporton se aktivitetet e tyre me Gjeoportalin Kombëtar gjatë vitit 2015 kanë pasur të bëjnë më shumë me popullimin e tij me të dhëna të reja, si Censusi i vitit 2011⁵, informacion për institucionet arsimore, rrugët, gjeologjinë, zonat e mbrojtura, vlerën e pronës, ndarjen territoriale, kadastrat, hartat topografike, ortofotot e kështu me radhë. Deri në shtator 2015, janë të ofruara falas në Gjeoportalin rreth 40 shërbime për institucionet dhe publikun e gjerë. Numri i shërbimeve të ofruara nga portali para

miratimit të planit të Veprimit PQH në qershor të vitit 2014 ishte rreth 8 deri në 10.

Vetë-vlerësimi i qeverisë arrin në përfundimin se angazhimi është zbatuar. Megjithatë, ai ende shtjellon objektiva të veçantë që mbeten ende për t'u përmbushur. Në tetor 2015, ASIG do të finalizojë Termat e Referencës për zhvillimin e softuerit dhe harduerit, në përputhje me Direktivën INSPIRE të Komisionit Evropian (KE). Kjo direktivë ka për qëllim të krijojë infrastrukturën e të dhënave hapësinore të Bashkimit Evropian, gjë që do të mundësojë shkëmbimin e informacionit hapësinor mjedisor mes institucioneve të sektorit publik dhe do të lehtësojë edhe më shumë aksesin e publikut tek informacionit hapësinor në të gjithë Evropën.⁶

Edhe pse versioni aktual beta i Gjeoportali ka qenë funksional që nga 2014, versioni i ri i këtij Gjeoportali që përmbush standardet INSPIRE është ende në një fazë të hershme të zhvillimit të tij. Përgatitja e të dhënave model dhe informacioni i ri gjeohapësinor (që do të përfshihen në Termat përfundimtarë të Referencës) do të duhet të përmbushë standardet e reja. Risetë që do të prezantohen me versionin e ri të portalit do të përfshijnë, mes të tjerash, mundësinë "shkarko" dhe standardet bashkëkohore për të dhënat e përgjithshme të ngarkuar në portal.

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Pavarësisht disa mbivendosjeve mes këtij portali dhe atij të INSTAT GIS (p.sh., për ndarjen territoriale, Censuri 2011) informacioni dhe shërbimet e ofruara përmes këtij Gjeoportali përfaqësojnë një moment të rëndësishëm për të dhënat e hapura dhe reformat e qeverisjes transparente. Po ashtu, portali mund të ndihmojë në informimin e politikë bërësve, kur duan të marrin vendime të bazuara në informacione. Aktualisht, Gjeoportali po mbështet edhe zbatimin e angazhimeve të tjera PQH, si "akses elektronik tek

zonat e mbrojtura" si dhe mjete të tjera të ngjashme, si Portali GIS i INSTAT.

ASIG nuk ka zhvilluar ende një kuadër monitorimi për përdorimin e Portalit dhe ndërgjegjësimi i tij ka qenë i kufizuar. Hulumtuesit MRP iu ofrua informacion vetëm për analizat e muajit korrik 2015, sipas të cilit portal kishte rreth 1000 vizitorë unikë. Të vetmit aktorë të informuar mbi Gjeoportalin Kombëtar dhe shërbimet e tij (p.sh., INSTAT) ishin disa organizata mjedisore të shoqërisë civile dhe disa institucione shtetërore të intervistuar nga hulumtuesi MRP.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile në fokus grupin e aktorëve kryesorë që u mbledhën për këtë raport ngritën shqetësime lidhur me mungesën e koordinimit ndërmjet institucioneve të ndryshme shtetërore në raport me nismat e mësipërme. Sipas përfaqësuesve të ASIG-t, nuk ka baza për shqetësime të tilla, për shkak se ky institucion ka një pasqyrë të plotë dhe po mbështet aktivisht zhvillimin e instrumenteve të ngjashme nga ana e institucioneve shtetërore.⁷

RRUGA PËRPARA

Ky angazhim është shumë i rëndësishëm për vlerat PQH dhe fazat e tij të avancuara mund të prodhojnë një ndikim transformues nëse shoqërohet me një koordinim të përshtatshëm me institucionet e tjera shtetërore dhe nëse ka një kuadër të përshtatshëm planifikimi dhe monitorimi. Ky raport përçon disa nga shqetësimet e ngritura nga përfaqësues të shoqërisë civile, veçanërisht në lidhje me nevojën për të informuar publikun për sa i përket informacionit dhe shërbimeve që mund të merren nëpërmjet Gjeoportalit.

Edhe pse objektivat për zbatimin e këtij angazhimi janë, në një farë mase, të shtjelluara në mënyrë të qartë, ka shumë rëndësi të sigurohet më shumë qartësi për afatet kohore për zbatimin e tyre në versionin e ri të portalit.

¹ Ligji nr. 72/2012, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturrës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" që gjendet tek adresa http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/183907828-LIGJ-Nr-72-2012-PER-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INFRASTRUKTURES-KOMBETARE-TE-INFORMACIONIT-GJEOPAPESINOR-NE-REPUBLIK-EN-E-SHIQPERISE.pdf.

² Gjeoportali, uebsajti i ASIG-it, vizituar/monitoruar gjatë 2014–15, marrë nga bit.ly/1K9WeZQ

³ Uebsajti i Autoritetit Norvegjez të Hartografimit, marrë nga bit.ly/1OLStz9

⁴ Uebsajti i Portalit GIS të INSTAT, marrë nga bit.ly/1IZpibx

⁵ "INSTAT Paraqet Sipas Ndarjes së re Territoriale Për Herë Të Parë të dhënat e Gjeoreferuara të Censurit 2011," INSTAT website, marrë nga bit.ly/1PotNsk

⁶ "Për INSPIRE," uebsajti i Direktivës INSPIRE, gjendet tek bit.ly/1Zh7QRA

⁷ Fokus grupe me aktorët kryesorë dhe intervista të tjerë me përfaqësues të ASIG (Klaudio Collaku, Erin Mlloja dhe Renaldo Agolli) në shtator 2015.

4.2 ZYRAT E SHËRBIMIT POLICOR

Teksti i angazhimit:

Qeveria shqiptare me synim sigurimin dhe lehtësimin e aksesit tek Shërbimi Policor do të ngrijë “zyra me një ndalesë” në çdo drejtori policie me qëllim: krijimin e një sporteli të unifikuar të pritjes për të gjitha shërbimet e ofruara, thjeshtimin e procedurave dhe kufizimin e numrit të dokumenteve që do të paraqiten.

Zyrat me një ndalesë do të përmirësojnë dhe do të bëjnë më efikas edhe bashkëpunimin polici-komunitet duke ndihmuar në krijimin e një komuniteti më të sigurt dhe në rritjen e pjesëmarrjes së publikut.

Aktualisht rajonet e drejtorive të policisë janë zona të mbyllura, ku qytetarët kanë shumë pak ose aspak akses. Ky angazhim ka për qëllim hapjen e shërbimeve policore për qytetarët duke u ofruar këtyre të fundit jo vetëm akses por edhe një shërbim më transparent, në kohë, duke shmangur kështu burokracinë dhe korrupsionin.

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët nëpërmjet këtyre zyrave do të rrisë besimin e tyre tek policia si dhe do të ndikojë në parandalimin e korrupsionit tek policia.

Rivendosja e komunikimit me publikun, përmes ofrimit të shërbimeve administrative dhe procedurale, synohet që të arrihet me anë të regjistrimit elektronik të nevojave dhe kërkesave të tyre, dhe përcjellja e tyre, së bashku me dokumentacionin përkatës në zyrën e shqyrtimit dhe zgjidhjen e problemit brenda koha, siç është planifikuar.

Zyrat e Shërbimit Policor do të ngrihen dhe funksionojnë në të gjitha strukturat policore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë tek drejtoritë e policisë dhe komisaritet në rrethe, të cilat do të kenë mjedise të hapura për publikun dhe do të funksionojnë 24 orë pa pushim, me sportele, për shërbimin administrativ dhe procedural.

Numri i zyrave të shërbimit të policisë që do të jenë të hapur, numri i shërbimeve që do të jenë në dispozicion për qytetarët, dhe numri i qytetarëve të shërbyer do të përdoren si tregues për të verifikuar zbatimin e këtij angazhimi.

Shënim redaksional: Përshkrimi i këtij angazhimi shtjellon një sërë veprimesh specifike që mund të kategorizohen në dy objektiva të rëndësishëm, si më poshtë:

1. Ngritja e një zyre me një ndalesë (me shërbim sporteli 24 orë në 7 ditë të javës) në çdo drejtori policie
 - a. Një sportel unik për të gjitha shërbimet e ofruara duke funksionuar me procedura të thjeshtësuara; dhe
 2. Regjistrimi elektronik i nevojave dhe kërkesave të qytetarëve dhe përcjellja e tyre tek zyra përkatëse.

Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
NË TËRËSI				X	X		X	X			X				X	
4.2.1 Hapja e zyrave me një ndalesë				X	X		X				X				X	
4.2.2 Regjistrimi elektronik i kërkesave të qytetarëve				X	X		X	X			X		X			

ÇFARË NDODHI?

Ky angazhim ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve policore ndaj qytetarëve përmes rritjes së efikasitetit, reduktimit të pengesave administrative dhe unifikimit të shërbimeve policore. Zyrat e Shërbimit të Policisë janë projektuar për të shërbyer si zyra me një ndalesë për qytetarët.

Ministria e Brendshme (MB) dhe Policia e Shtetit Shqiptar (PSH) kanë bërë përparim të konsiderueshëm drejt zbatimit të këtij angazhimi, gjatë vitit të parë (2014-15) dhe ka të ngjarë ta përfundojnë zbatimin e tij para afatit, në fund të vitit 2016. Për më tepër, ky angazhim ka prodhuar veprime shtesë nga ana e policisë, përtej detyrimeve sipas Planit të Veprimit PQH, për të marrë hapa të reja drejt nxitjes së qytetarisë proaktive përmes prezantimit të aplikacionit "Komisariatit dixhital".

Përgatitjet për zbatimin e këtij angazhimi nisën në vitin 2014¹, me mbështetjen e Projektit të financuar nga SIDA "Policimi Suedez-Shqiptar në Komunitet (SACP).²

Objektivi i parë është përfunduar në mënyrë të konsiderueshme. Deri në shtator 2015, Zyrat e Shërbimit Policor (sportele me një ndalesë), ishin hapur në shumicën e drejtorive rajonale të policisë në vend (në nëntë nga dymbëdhjetë gjithsej). Disa nga detyrat e tyre janë informimi i qytetarëve për shërbimet e policisë; pranimi i aplikimeve, ankesave, kërkesave ose komunikimeve të tjera të qytetarëve; përpunimi i aplikimeve; përditësimi i aplikantët mbi ecurinë e aplikimit të tyre, e kështu me radhë. Informacioni mbi shërbimet e policisë gjendet edhe në faqen e internetit të Policisë së Shtetit.³ Sipas Urdhrit të Ministrit të Brendshëm në mars 2015, qytetarëve iu shërbejnë oficerë civilë në zyrat e Shërbimit të Policisë.

Objektivi i dytë i këtij angazhimi ka nivel zbatimi të kufizuar. Gjatë vitit 2015, aplikimi për regjistrimin elektronik të kërkesave të qytetarëve është zhvilluar dhe testuar në disa nga zyrat e krijuara për disa shërbime, të tilla si deklaratat për humbje dokumenti, autorizimet për armët e gjuetisë dhe kështu me radhë. Bazuar në këtë testim, ka pasur përmirësime të mëtejshme të aplikacionit. Ky i fundit lejon që kërkesat e qytetarëve të përpunohen në mënyrë elektronike dhe të kanalizohen për në drejtoritë përkatëse të policisë si skedar elektronik. Qytetarëve u jepet

një faturë elektronike ku deklarohet lloji i shërbimit të aplikuar, dokumentet e paraqitura, si dhe afati i fundit për përgjigje nga policia. Aktualisht, aplikimi është gati për përdorim, por nuk ishte instaluar ende plotësisht në të gjitha zyrat e Shërbimit të Policisë deri në shtator 2015. Ky përfundim i paplotë është për shkak të investimeve të tjera që janë të nevojshme për të përmirësuar kapacitetin e serverit IT dhe cilësisë së lidhje me internetin në disa komisariate policie. Gjatë vitit të kaluar janë organizuar disa trajnime të stafit në zyrat e Shërbimit të Policisë. Trajnime të tjera shtesë për teknologjinë e informacionit dhe komunikimin pritet të bëhen deri në fund të vitit 2015. Edhe pse raporti i vetë-vlerësimit thekson se ky angazhim është zbatuar, ai shtjellohet për sa më sipër si "veprime në pritje të miratimit ose zbatimit."

Përveç masave për zbatimin e këtij zotimi, MB dhe Policia e Shtetit kanë nisur që nga maji i 2015 aplikacionin për telefona celularë "Komisariatit Dixhital" që u zhvillua në bashkëpunim me Vodafone Shqipëri.⁴ Ky aplikacion është projektuar për të nxitur një ndërveprim më të madh mes policisë dhe publikut, duke u bërë të mundur qytetarëve të raportojnë në mënyrë proaktive korrupsionin dhe aktivitetet e tjera të paligjshme⁵. Me një mesatare prej rreth 5,500 raportimesh të qytetarëve në muaj, ky aplikacion bëri që numri i raporteve të paraqitura nga qytetarët deri në fillim të shtatorit 2015 të arrinte në rreth 22,000. Shumica e rasteve të raportuara kishin të bënim me shqetësimin e parkimit të parregullt, por raportime të tjera përfshinin edhe sjellje të keqe të policisë, ndërtime të paligjshme e kështu me radhë. Qytetarët që kanë instaluar aplikacionin mund të dërgojnë denoncime mjaft lehtë nga celularët e tyre.

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Ky angazhim përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së besimit të publikut dhe marrëdhënieve polici-qytetar duke i bërë shërbimet e policisë më të hapura, më efikase dhe më transparente. Përfaqësues të shoqërisë civile të intervistuar nga hulumtuesi MRP theksuan potencialin e këtij angazhimi për përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve policore, si dhe krijimin e besimit të publikut. Pavarësisht përmirësimeve dhe reformave gjatë viteve të fundit, korrupsioni në policinë shqiptare

përbën ende një shqetësim serioz.⁶ Një studim i IDM në vitin 2014 mbi integritetin e policisë dhe korrupsionit në Shqipëri nënvizon se “korrupsioni policor është i përhapur dhe lidhet me karakteristikat dhe kulturën organizative të shërbimeve policore.”⁷

Angazhimi synon drejtpërsëdrejti tre vlerat PQH, përkatësisht “Aksesi në informacion”, “llogaridhënia publike”, dhe “Teknologjia dhe Inovacioni për Transparencë dhe Llogaridhënie”. Megjithatë, ekspertët e pavarur thonë se angazhimi duhet të shoqërohet me masa më gjithëpërfshirëse monitorimi dhe llogaridhënieje. Disa prej masave konkrete të propozuara në këtë drejtim përfshijnë vlerësimin e menjëhershëm nga qytetarët të shërbimeve në zyrat e shërbimit të policisë, analiza në dispozicion të publikut, përfshirë të dhënat për treguesit e performancës (p.sh., numri i ankesave / kërkesave të pranuar dhe të përpunuara në zyrat e shërbimit të policisë, koha mesatare e përpunimit, llojet e shërbimeve më të kërkuara) e kështu me radhë. Këto masa do të ndihmojnë edhe Policinë e Shtetit për të përmirësuar performancën e saj dhe për planifikimin e burimeve. Përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për këtë angazhim argumentuan se aplikacioni i zhvilluar për menaxhimin elektronik të kërkesave të qytetarëve në këto zyra siguron mundësi të tilla. Në të njëjtën kohë, investimet e mëtejshme në kapacitetin e serverit dhe lidhjen e tij do të jetë me përfitim për institucionet e policisë.

Institucionet përgjegjëse të intervistuar nga MRP nuk paraqitën të dhëna dhe informacione të tjera për performancën e Zyrave të Shërbimit të Policisë deri në kohën e shkrimit të këtij raporti (në fund të shtatorit 2015). Gjithashtu, gjatë vitit 2015 nuk është analizuar performanca e këtyre zyrave. Përfaqësuesi i MB sugjeroi se një analiza e tillë është planifikuar të mbahet në fund të vitit 2015.

RRUGA PËRPARA

Me gjithë progresin e dukshëm në zbatimin e këtij angazhimi, nevojiten më shumë përpjekje të bashkërenduara për zbatimin e plotë të objektivit të dytë për zbatimin e regjistrimit elektronik të kërkesave të qytetarëve. Duhet bërë investime për të përmirësuar kapacitetet e serverit IT dhe lidhjen me internet të komisariateve të policisë në të gjithë vendin deri në fund të vitit 2016.

Disa nga rekomandimet për këtë zbatimin e këtij angazhimi janë edhe të mëposhtmet:

- Të përfundohet hapja e zyrave të shërbimit policor në pjesën e mbetur të komisariateve dhe të bëhet trajnimi cilësor i stafit
- Të shqyrtohet mundësia e partneritetit me shoqërinë civile ose organizata të komunitetit për të monitoruar performancën e zyrave të shërbimit policor
 - o Kjo është edhe në përputhje me rekomandimin e parë nga përfaqësues të shoqërisë civile, rekomandim që u shtjellua gjatë konsultimit për PV (28 mars 2014)
- Të prezantohen instrumente të vlerësimit anonim nga qytetarët për punën e zyrave të shërbimit policor
- Të instalohet aplikacioni për regjistrimin elektronik të kërkesave të qytetarëve në të gjitha zyrat funksionale të shërbimit policor dhe të botohen të dhëna që tregojnë performancën e zyrave sipas këtij aplikacioni
- Të bashkërendohet puna me portalin www.stopkorrupsionit.al portal dhe të sigurohet që shmangen mbivendosjet me aplikacionin “Komisariati Dixhital”.

¹ Marrë nga bit.ly/1N5aliX. Shih edhe prezantimin (datë 23.07.2014) faqen e Ministrisë së Brendshme, marrë nga bit.ly/113eEF2

² Marrë nga bit.ly/22XE0en

³ Marrë nga bit.ly/1m5SmqC

⁴ Marrë nga bit.ly/1Q2GDle

⁵ Aplikacioni për Android marrë nga bit.ly/1QLCxMm, dhe aplikacioni për iOS marrë nga apple.co/1ONulql. ⁶ Shih Progres Raporti i KE për Shqipërinë 2014 f. 2, marrë nga bit.ly/1BQGIgC

⁶ Shih Progres Raporti i KE për Shqipërinë 2014 f. 2, marrë nga bit.ly/1BQGIgC

⁷ Integriteti i Policisë dhe Korrupsioni në Shqipëri, IDM 2014, marrë nga bit.ly/1mSU9Mo

GRUPI 1: DENONCIMI I KORRUPSIONIT

Ky grup përbëhet nga dy angazhime, si më poshtë:

1.1 STANDARDIZIMI I ANKESAVE PËR KORRUPSION

Teksti i angazhimit:

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në rolin e Koordinatorit Kombëtar për Anti-Korrupsionin, do të ndërmarrë standardizimin e procesit në lidhje me ankesat që trajtojnë korrupsionin. Aktualisht, edhe pse shumë ministri kanë ngritur linjën e gjelbër ose forma të tjera për të denoncimin e korrupsionit, nuk ka ende një procedurë të standardizuar, që të sigurojë transparencë në shqyrtimin e ankesës dhe afatet konkrete për të siguruar një shërbim të mirë. Disa nga treguesit dhe objektivat e përcaktuara për këtë angazhim janë hartimi i udhëzimeve përkatëse për trajtimin e ankesave të korrupsionit, integrimin e tyre në një plan rregullash për transparencën në çdo ministri, publikimin e tyre online. Duke pasur parasysh specifikat dhe vështirësitë e luftës dhe hetimit të korrupsionit, ky sistem, nëpërmjet

standardizimit të proceseve, mund të rrisë besimin tek administrata dhe të rrisë numrin e informatorëve. Ministrinë do të duhet të publikojnë zyrtarisht standardet përkatëse dhe të informojë publikun për ecurinë e çështjeve të veçanta, duke rritur nivelin e përgjegjshmërisë së administratës publike. Ky angazhim do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës në lidhje me procedurat e ankimimit. Në fakt, deri më tani nuk ka asnjë informacion të qartë se si mund të trajtojë një ankesë në rastet e korrupsionit qytetari. Publikimi i këtyre "standardeve" jo vetëm që do të krijojë uniformitet në mënyrën e trajtimit të ankesave, por do të shërbejë edhe për rritjen e efikasitetit të administratës publike në trajtimin e ankesave për korrupsion.

4.1 STANDARDIZIMI I ANKESAVE PËR KORRUPSION

Teksti i angazhimit:

Aktualisht, besimi i publikut tek administrata publike është i ulët, ndërsa rreziku me të cilin do të përballet një informator kur denoncon rastet e korrupsionit është shumë i lartë. Në Shqipëri, nuk ka një kuadër të qartë që të sigurojë bashkëpunimin me informatorët dhe të mbrojë sinjalizuesit (informatorët). Ky ligj, së bashku me fushatën sensibilizuese që do të pasojë, do të sigurojë që sinjalizuesit që do t'i besojnë agjencive të zbatimit duke i dhënë atyre informacion në lidhje me korrupsionin në sektorët ku punojnë apo janë të përfshirë, do të kenë mbrojtje. Ky ligj do të rrisë jo vetëm transparencën dhe raportimin e rasteve të korrupsionit, por edhe besueshmërinë e administratës.

Aktualisht ekziston një projektligj, i cili për momentin është në konsultim. Ligji është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit 2014-2017, e cila parashtron të dy objektiva: parandalim dhe ndërgjegjësim. Për më tepër, miratimi i ligjit është pjesë e angazhimit për Prioritetin Nr. 3 të udhërrëfyesit për luftën kundër korrupsionit në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE.

Do të ketë një konsultim të gjerë me agjencitë qeveritare dhe donatorët, ndërsa janë planifikuar edhe takime konsultimi me shoqërinë civile dhe sektorin e biznesit. Pas këtyre konsultimeve, drafti do të redaktohet për të reflektuar komentet, dhe pas konsultimeve të mëtejshme të brendshme dhe të

përfundojë në vjeshtë dhe të miratohen para mbylljes së këtij viti.

Shënim redaksional: Ky grup (C. 1) bashkon dy angazhime të veçanta me qëllim sigurimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore për luftën kundër korrupsionit. Të dy ata janë ndërmarrë nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Koordinator Kombëtar për Anti-korrupsionin në Shqipëri.

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Institucion(et) mbështetës(e): Ministrinë, Kuvendi

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
1.1 Standardizimi i ankesave për korrupsion			X				X				X				X	
4.1. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve				X			X				X		X			

ÇFARË NDODHI?

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve (informatoreve) dhe standardizimi i procedurës së ankesave për korrupsionin janë ngritur si çështje shqetësuese nga ana e organizatave të ndryshme të shoqërisë civile në këto vitet e fundit. Të dy angazhime janë aktualisht pjesë e Strategjisë së Shqipërisë Kundër Korrupsionit 2015-20 dhe Planit të saj të Veprimit 2015-17. Në nëntor të vitit 2013, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar për Anti Korrupsionin, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore nisi procesin e konsultimit me aktorët qeveritarë dhe të shoqërisë civile për një strategji të re kundër korrupsionit dhe për planin e veprimit. Strategjia përdor një përfaqje të trefishtë: parandalim, ndëshkim, dhe ndërgjegjësimi, dhe fillimisht pritej të mbulonte periudhën 2014-2017. Megjithatë, pas shqyrtimit të gjithanshëm me agjencitë shtetërore dhe konsultimeve me shoqërinë civile u siguruan kontribute që bënë të nevojshme përmirësime të mëtejshme në këtë projekt dokument. Rrjedhimisht, Strategjia

Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-20 dhe Planin e saj të Veprimit për periudhën 2015-17 janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 247, datë 20.03.2015.

Standardizimi i procedurës së ankesave kundër korrupsionit dhe Ligji për sinjalizuesit janë pjesë e qasjes së parandalimit të evidentuar në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (Objektivi A 4: Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve kundër korrupsionit). Planin PQH të Veprimit të Qeverisë 2014-16 e vë Ligjin për sinjalizuesit brenda një afati të qartë kohor (në fund të vitit 2014), ndërsa për standardizimin e procedurave të ankesave kundër korrupsionit është supozuar se afati i fundit për zbatimin e tij është viti 2016. Planin e Veprimit 2015-17 të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-20 e shtyu afatin për Ligjin për Bilbilfryrësit për muajin qershor 2015, ndërsa zbatimi i masave të lidhura me të, të tilla si hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore si dhe ngritja e forcimit të strukturave shtetërore për zbatimin e tij, është lënë për në fund të

vitit 2016.

1.1 Standardizimi i ankesave për korrupsion

Angazhimi i parë ka për qëllim standardizimin e procedurës së ankesave ndaj korrupsionit dhe publikimin e rregullave të transparencës brenda çdo ministrie. Plani i Veprimit PQH 2014-16 shtjellon objektivat për standardizimin e procedurave të ankesave kundër korrupsionit. Megjithatë, Strategjia Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit ofron një pasqyrë më të mirë të objektivave dhe masave për këtë angazhim. Sipas Strategjisë, standardizimi i procedurës së ankesave kundër korrupsionit do të arrihet përmes:

1. Krijimit të një qasjeje unike për trajtimin e rasteve të korrupsionit të raportuara nga publiku i gjerë;
2. Rritjen e besimit tek administrata publike me anë të transparencës në trajtimin e denoncimeve dhe publikimit të të dhënave përkatëse; dhe
3. Shpërndarjes në formë elektronike të ankesave dhe gjurmimit në të gjithë procesin e shqyrtimit administrativ pas paraqitjes së ankesës nga qytetari.

Ky angazhim është zbatuar në mënyrë të konsiderueshme. Më 5 mars 2015, Kryeministri ka nxjerrë Urdhrin "Për miratimin e rregullores për procedurat e regjistrimit, shqyrtimit dhe ruajtjes së praktikave korruptive të denoncuar në faqen unike të denoncimit të korrupsionit" (www.stop.korrupsionit.al). Urdhri i Kryeministrit përcakton rregullat për funksionimin e portalit; procedurat për bashkëpunim dhe komunikim me institucionet përgjegjëse (qendrore); dhe rregullat për funksionimin e Zyrës Operacionale lidhur me Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit. Portali antikorrupsion, që u hap në fillim të muajit shkurt 2015, i jep një mundësi qytetarëve të dërgojnë ankesat kundër korrupsionit në internet përmes një procesi mjaft praktik duke ngarkuar prova e fakte (d.m.th., fotografi, video, dokumente). Qytetarët mund të zgjedhin që të bëjnë të ditur identitetin e tyre ose të mbeten anonimë. Raporti i paraqitur kanalizohet automatikisht me e-mail në Zyrën Operacionale, Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion, dhe personat përgjegjës në zyrën e kryeministrit dhe në ministrinë përkatëse.

Qytetarët mund të zgjedhin një fushë të caktuar, të tilla si gjyqësori, arsimi, shëndetësia, policia, doganat, autoritetet tatimore, dhe institucionet shtetërore përkatëse me të cilët lidhet denoncimi i kryer. Nëse ata nuk e kanë bërë një gjë të tillë, Zyra Operacionale e kalon raportin me e-mail të institucionit përkatës. Shqyrtimi i këtyre raporteve kryhet me anë të një sistemi të ndjekjes së çështjes, sistem që ofron një pasqyrë të statusit të raportit (p.sh., paraqitur, në shqyrtim, zgjidhur, apo mbyllur) që i cakton një numër unik rastit të regjistruar. Ankuesit mund të ndjekin ecurinë e rastit të raportuar prej tyre në portal, me kusht që ato të mos jenë anonime. Institucionet e autorizuara shtetërore duhet të shqyrtojnë raportet dhe ankesat e tjera të paraqitura përmes portalit brenda 30 ditëve nga regjistrimi i tyre.

Edhe pse portali i është përgjigjur nevojës për standardizimin e procedurave në trajtimin e ankesave dhe denoncimeve për korrupsionin, shumë ministri nuk kanë publikuar programet e tyre të transparencës, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjet e tyre. Kjo masë e fundit rrjedh si detyrim nga Ligji për të Drejtën e Informimit (2014), i cili përcakton (në nenet 4 deri 10) se çdo institucion shtetëror duhet të publikojë në internet informacione për programin e transparencës, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe koordinatorin e të drejtës së informimit. Ndonëse disa ministri dhe agjenci qeveritare e kanë publikuar këtë informacion, sipas një formulari të hartuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,¹ shumë institucione të tjera nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Për më tepër, edhe mes ministrive që kanë publikuar këtë informacion, shpesh ka mospërputhje me disa prej tyre që publikojnë vetëm modelin e programit të transparencës apo kontaktet e koordinatorit në institucionin përkatës. Hulumtuesi MRP ka konstatuar se seksionet "Transparenca" në faqet e ministrive nuk kanë standard të unifikuar për trajtimin e ankesave të korrupsionit (shtator 2015). Vetë-vlerësimi i qeverisë i referohet këtij angazhimi si në zbatim e sipër. Megjithatë, ky vetë-vlerësim nuk shtjellon numrin e institucioneve qendrore që kanë martuar rregulla dhe standarde të transparencës deri në fund të periudhës së raportimit (30 qershor 2015).

4.1. Ligj për mbrojtjen e sinjalizuesve

Strategjia Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit e

konsideron Ligjin për sinjalizuesit si një mjet për mbrojtjen e integritetit të lartë të zyrtarëve dhe për monitorimin e veprimtarisë shtetërore. Për këtë qëllim, Shqipëria do të (1) të miratojë ligjin dhe aktet nënligjore që e shoqërojnë, dhe (2) do të krijojë dhe të forcojë strukturat përgjegjëse brenda dhe jashtë institucioneve për të trajtuar rastet e korrupsionit.

Hulumtuesi MRP konstaton përparim të kufizuar në zbatimin e këtij angazhimi, gjatë periudhës së raportimit. Edhe pse në bazë të Planit të Veprimit, projektligji pritej të miratohej deri në fund të vitit 2014, ky afat u shty për mesin e vitit 2015 sipas Planit të Veprimit 2015-17 të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-20. Sipas këtij dokumenti, zbatimi i masave të tjera që lidhen me këtë ligj (p.sh., miratimi i akteve nënligjore, krijimi dhe forcimi i strukturave shtetërore për zbatimin e tij), pritet të përfundojë në fund të vitit 2016. Megjithatë, zbatimi i këtij angazhimi është prapa afatit edhe sipas këtij afati kohor të rishikuar. Teksti i projektligjit ishte nën shqyrtim para Planit të dytë të Veprimit PQH (siç përshkruhet në angazhim). Ky tekst u përmirësua më tej nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, me asistencë të huaj teknike dhe ekspertizë nga Universiteti i Utrecht-it, me mbështetje financiare nga Qeveria e Holandës.

Më 12 shtator 2014, MSÇV dhe Ministria e Drejtësisë organizuan një konsultim me grupet e shoqërisë civile, ekspertë dhe agjenci të tjera shtetërore.² Një tjetër proces i hapur konsultimi u mbajt më 26 shkurt 2015 me shoqërinë civile, sektorin privat, agjencitë shtetërore, përfaqësues dhe ekspertë nga misionet e asistencës së huaj dhe organizatat ndërkombëtare.³ Sipas shumë organizatave të shoqërisë civile, procesi konsultativ për hartimin e këtij ligji ka qenë shumë i hapur dhe gjithëpërfshirëse. Nga qeveria u raportuan disa komente dhe rekomandime prej përfaqësuesve jo-shtetërore gjatë këtij viti. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, projektligji ishte duke u finalizuar nga ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë. Përfaqësuesit e MSÇV i raportuan MRP se miratimi i këtij ligji nga Kuvendi do të bëhej nga fundi i vitit 2015. Qeveria holandeze do të vazhdojë të mbështesë zbatimin e këtij ligji, nëpërmjet mbështetjes teknike dhe ekspertizës për përgatitjen e akteve nënligjore lidhur me të, ngritjen e strukturave institucionale dhe me trajnimet përkatëse.⁴

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Të dy angazhimet hedhin baza të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit dhe në përpjekjet për të konsoliduar transparencën dhe llogaridhënien e administratës publike në Shqipëri. Qasja e MSÇV për zbatimin e këtyre angazhimeve ka qenë efektive dhe mjaft gjithëpërfshirëse.

Nevoja për standardizimin e proceseve për ankesat kundër korrupsionit theksohej edhe në raportin e parë MRP për Shqipërinë (2013), i cili rekomandonte integrimin e portaleve online, duke u bërë të mundur qytetarëve të raportonin korrupsionin dhe shkelje të tjera në gjyqësor.⁵ Nga ana tjetër, Ligji për sinjalizuesit ka qenë objekt i punës së shoqërisë civile kohët e fundit dhe në përpjekjet për përmirësimin e luftës kundër korrupsionit.⁶ Sipas MSÇV, ka pasur vonesa në lidhje me miratimin e këtij ligji për shkak të konsultimeve të gjera me ekspertë të shtetit dhe të shoqërisë civile, konsultime që e kanë përmirësuar ndjeshëm draftin.⁷

1.1 Standardizimi i ankesave për korrupsionin

Portali për denoncimin e korrupsionit përbën një hap të madh përpara në ngritjen e mekanizmave efektive për ankesat e qytetarëve. Kjo nismë ka rezultuar e suksesshme. Sipas përfaqësuesve MSÇV, shumë prej praktikave të denoncuara të korrupsionit apo shkeljeve të tjera në institucione të ndryshme janë pasuar nga procedurat administrative ose gjyqësore. Sipas përfaqësuesve të qeverisë, mbi 1,000 raporte janë denoncuar në portalin brenda ditëve të para të funksionimit të tij. Numri i rasteve të raportuara arriti rreth 7.000 deri në fund të qershorit 2015.⁸ Në kohën e shkrimit të këtij raporti, në total 4,310 raste korrupsioni ishin zgjidhur ose mbyllur, ndërsa një tjetër numër prej 2,318 ishin refuzuar. Sipas rregullores, statusi "refuzuar" i vihet ankesave që nuk denoncojnë një praktikë apo çështje të veçantë. Ky status caktohet në rastet kur qytetarët që kanë bërë raportimin nuk arrijnë të japin informacion shtesë brenda tri ditësh kur iu kërkohet nga zyra përkatëse. Shumica e raportimeve të paraqitura janë "ankesa", ndërsa vetëm një numër i vogël i raportimeve kanë denoncime konkrete të praktikave korruptive. Portali ka regjistruar mbi 1,000 duplikime rastesh (ankesë e paraqitur më shumë se një herë nga i njëjti ankimes). Numri më i madh i

rasteve (në gusht 2015) lidhen me sistemin e arsimit, shëndetësisë, policisë, gjyqësorin si dhe rastet e ndërtimeve/punimeve të paligjshme.

Megjithatë, përfaqësuesit e OShC-ve që morën pjesë në fokus grupet e realizuara nga hulumtuesi MRP kanë ngritur shqetësime në lidhje me rezultatin e rasteve të “zgjidhura”. Ata vënë në dukje se “nuk është numri i raporteve të paraqitura, por rezultati i rasteve të denoncuar të korrupsionit që duhet të përdoren për vlerësimin e efektivitetit të këtyre mjeteve”. Në përgjigje të kësaj pyetjeje përfaqësuesit e MSÇV thonë se nuk kanë informacion mbi statusin e ankesat që kanë kallëzuar në prokurori.

OShC-të sugjerojnë se në mungesë të informacionit në lidhje me “çfarë ndodhi pas raporti të bërë dhe çfarë masash konkrete u morën”, publiku mund të humbasë interes dhe madje edhe të bëhet skeptik për këto mjete.

4.1 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve

Projektligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve përcakton rregullat për mbrojtjen e sinjalizuesve në sektorin publik dhe privat, të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private. Objektivi i kësaj nisme është parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorin publik dhe privat, për të mbrojtur informatorët, dhe për të inkurajuar denoncimin e praktikave korruptive. Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji mund t'i japë një shtysë të re përpjekjeve anti-korrupsion në Shqipëri, veçanërisht në luftën kundër pandëshkueshmërisë. Konsultimet e kryera nga MSÇV dhe Ministria e Drejtësisë me institucionet shtetërore, sektorin privat si dhe me ekspertë të shoqërisë civile kanë sjellë përmirësime të rëndësishme në draftin paraprak të vitit 2014. Përveç kësaj, ekspertiza e huaj dhënë përmes asistencës së

Ambasadës së Holandës kanë sjellë praktikën më të mira evropiane në këtë projektligj.

Projektligji pritet të hyjë në procedurën parlamentare dhe të miratohet deri në fund të vitit 2015. Deri në kohën e hartimit të këtij raporti MRP (në fund të shtatorit 2015), qeveria nuk e ka paraqitur ende projektligjin në parlament.

RRUGA PËRPARA

Zbatimi i këtyre angazhimeve duhet të finalizohet dhe të përforcohet edhe më tej. Me qëllim përfundim e “Standardizimit të proceseve për ankesat që kanë të bëjnë me korrupsionin”, hulumtuesi MRP rekomandon që qeveria të marrë masa për të siguruar që standardet e unifikuar për trajtimin e ankesave për korrupsion të publikohen në seksionet “Transparenca” të faqeve të ministrive. Hulumtuesi MRP sugjeron fuqimisht që portali të përdoret vazhdimisht dhe të promovohet edhe më tej tek publiku i gjerë, sidomos përmes aksesit të tij tek provat e rezultateve të punës së këtij portali. Duke qenë se Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri ka nisur një studim për kënaqshmërinë me Portalin (tetor 2015), ka shumë rëndësi të përmirësohet zbatimi i tij i mëtejshëm në bazë të përvojës dhe këshillave të përdoruesve.

Grupet e interesit të intervistuar për këtë raport rekomandojnë që Projekt Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve të miratohet sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të mundësojë përgatitjet e duhura për zbatimin e tij. Aktivitetet e planifikuara të MSÇV në këtë drejtim janë realiste, ndërsa mbështetja e vazhdueshme me asistencë teknike dhe ekspertizë të huaj do të përmirësojë procesin dhe do të kontribuojë në shpërndarjen në kohë të kuadrit të plotë të zbatimit të ligjit.

¹ Marrë nga bit.ly/1mV5V9I

² Marrë nga bit.ly/1Rkj7Bo

³ Marrë nga bit.ly/1ONMTfH

⁴ Intervistë me Juliana Hoxhën, Drejtore e Partnerët Shqipëri, OJQ e kontraktuar nga Ambasada e Holandës në Tiranë.

⁵ “Ankesat Online të qytetarëve në sistemin gjyqësor”, Progres Raport 2011–13 MRP Shqipëri, f. 63, marrë nga bit.ly/1Q38Wjm

⁶ “Mbrojtja e sinjalizuesve në Shqipëri: Vlerësim i Legjislacionit dhe Praktikës,” Programi i Shtetit Ligjor Evropa Juglindore, Konferencë e sponsorizuar nga Fondacioni Konrad Adenauer, nëntor 2013, marrë nga bit.ly/1RkkiRb

⁷ Intervista me MSÇV dhe përfaqësues të Ambasadës së Holandës në Tiranë

⁸ Raportet prill-Gusht 2015, marrë nga bit.ly/1PUWjVK

GRUPI 2: TË DHËNAT E HAPURA DHE E-SHËRBIMET

Ky grup përbëhet nga dy angazhime, si më poshtë:

1.3 ZBATIMI I MODULIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE NË FORMATIN "TË DHËNA TË HAPURA"

Teksti i angazhimit:

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në kuadër të nismës globale "Partneritet për Qeverisje të Hapur", do të ndërmarrë si angazhim zbatimin e një moduli që do të lejojë në një format të hapur të të dhënave qasje online për informacion mbi të dhënat buxhetore të ministrive.

Ky modul do të aksesohet nga portali qeveritar

e-Albania dhe faqet zyrtare të institucioneve përkatëse. Ai do të sigurojë informacion në kohë reale të shpenzimeve buxhetore të Këshillit të Ministrave dhe ministrive të linjës për të garantuar informacion të plotë dhe transparent të shpenzimeve. Treguesit e tillë si funksionaliteti i modulit, numri i vizitorëve të faqeve ose informacioneve të shkarkuara do të përdoren për të verifikuar zbatimin e këtij angazhimi.

3.3 E-ALBANIA

Teksti i angazhimit:

Portali E-Albania shërben si një pikë e vetme kontakti për shërbime qeveritare, duke ndihmuar në përmirësimin e aksesit të përgjithshëm të informacionit për publikun. Platforma e Interoperabilitetit (ndërveprueshmërisë) mbi të cilën është bazuar ky portal mund të zgjerohet për shërbime të tjera thelbësore qeveritare. Deri tani, janë publikuar të dhëna për 170 shërbimet e ofruara nga administrata publike. Shërbime si aksesit tek të dhënat personale, të dhënat e biznesit, dhe deklarimi online i të ardhurat personale do të shtohen së shpejti si e-shërbime të ofruara nga portali. E-Albania do të pasurohet me e-shërbime të tjera të ndryshme publike.

Qëllimi i këtij angazhimi është të kalojë nga shërbimet e nivelit të parë (shërbimet informuese) në nivelin e 3 dhe 4, që do të thotë shërbimet publike që ofrohen tërësisht online. Pritet që gjatë vitit 2015, të ofrohen 10 shërbime të reja tërësisht në internet dhe 10 të tjera do të shtohet

në vitin 2016.

Shënim redaksional: Të dyja angazhimet do të zbatohet nga MIAP dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI). Përveç kësaj, publiku do të ketë akses tek rezultatet e tyre përmes portalit e-Albania-angazhimi i parë jep një "modul të shpenzimeve publike" me të dhëna të hapura dhe angazhimi i dytë zgjeron numrin e e-shërbimeve që aksesohen përmes portalit e-Albania.

Institucioni përgjegjës: MIAP dhe AKSHI

Institucion(et) mbështetës(e): Ministrinë

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
1.1 Standardizimi i ankesave për korrupsion			X			X				X				X		
4.1. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve				X		X					X		X			

ÇFARË NDODHI?

Këto angazhime kanë për qëllim përmirësimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe aksesit tek informacionet dhe shërbime qeveritare nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit.

Konkretisht, moduli i shpenzimeve publike mundëson transparencën dhe përgjegjshmërinë e shpenzimeve qeveritare. Nga ana tjetër, nisma e-Albania është projektuar si një portal përmes të cilit qytetarët mund të aksesojnë informacione dhe mund të marrin e-shërbimet e ofruara nga institucionet shtetërore.

Objektivat e të dy angazhimeve i referohen fillimisht Planin e parë të Veprimit OGP të Shqipërisë 2012-13, të tilla si zgjerimi i shërbimeve elektronike ofrohen përmes portalit e-Albania, dhe pagesat e përditshme të bëra nga agjencitë qeveritare.¹

1.3. Moduli i shpenzimeve publike në formatin e “të dhënave të hapura”

Ky angazhim është zbatuar në mënyrë të konsiderueshme. Në shkurt 2015, Këshilli i Ministrave miratoi dokumentin e politikave për zbatimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e një portali të të dhënave të hapur. Dokumenti hap rrugën për botimin e të dhënave qeveritare në formatin e të dhënave të hapur, caktimin e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) si përgjegjëse për zhvillimin dhe administrimin e portalit opendata.gov.al.

Moduli që shfaq informacione për buxheti e Këshillit të Ministrave dhe ministrive në një format të të dhënave të hapura u publikua në fund të vitit 2014

në faqen e Këshillit të Ministrave. Një lidhje për këtë modul në faqen e internetit të Qeverisë gjendet edhe në faqet e internetit të disa ministrive të linjës.² Aktualisht, moduli ofron informacion mbi të dhënat e shpenzimeve të qeverisë nga data 1 janar 2015. Megjithatë, informacioni mbi shpenzimet e qeverisë dhe të ministrive shfaqet si përqindje e buxhetit të tyre përkatës dhe kjo nuk jepet në shifra reale të buxheteve. Vizitorët mund vetëm të aksesojnë informacionin e paraqitur (jo të dhëna të hapura) për qeverinë apo të një ministrie të veçantë, në përputhje me një total prej 11 kategorive të shpenzimeve. Prandaj, moduli nuk i plotëson kriteret për një standard të të dhënave të hapur me pesë yje siç parashikohet në Planin e Veprimit.³

3.3 e-Albania Portal

Ky angazhim është përfunduar në mënyrë të konsiderueshme. Gjatë vitit të kaluar, portali e-Albania ka rritur numrin e shërbimeve të ofruara nga 177 në vitin 2013 në një total prej 700 deri në shtator 2015. Megjithatë, shumica e këtyre shërbimeve janë “informacione dhe udhëzime” (shërbime të nivelit të parë) për qytetarët dhe për shërbimet e ndryshme të institucioneve shtetërore që qytetarët apo bizneset mund të përdorin. Shërbimet me funksione interoperabiliteti, të cilat do të mundësojnë shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit, janë të kufizuara. Ambicia e këtij angazhimi është të lëvizë në drejtim të shërbimeve që ofrohen tërësisht online, të tilla si shërbime plotësisht të integruara. Vetë-vlerësimi i qeverisë (tetor 2015) raporton se deri në fund të

vitit 2015 portali do të përfshijë 75 e-shërbime të reja (nivelet 3-4) që do të ofrohen online.

Raporti i Progresit i MRP Shqipëri 2013 sugjeron zgjerimin e funksionalitetit të interoperabilitetit të e-Albania tek shërbime të tjera publike, dhe popullimi i portalit me më shumë informacion dhe shërbime, e cila do të përmirësojë pamjen dhe do të nxisë përdorim më të madh të portalit.⁴

Regjistrimi i përdoruesit tek portali është ende një kërkesë për të hyrë në shërbimet e ofruara nga portali e-Albania. Përfaqësuesit e AKSHI të intervistuar nga hulumtuesi MRP raportojnë se regjistrimi është i domosdoshëm me qëllim që qytetarët dhe bizneset të ndërveprojnë me institucionet shtetërore. E njëjta gjë vlen edhe për shërbimet elektronike që përdoren nga administrata publike përmes portalit të e-Albania. Megjithatë, hulumtuesi MRP ka identifikuar disa shërbime të portalit e-Albania (ku duhet të jesh i regjistruar për t'i përdorur) që ofrohen edhe në faqet e internetit të agjencive të tjera qeveritare por pa qenë e nevojshme të jesh i regjistruar, të tilla si kontroll online të gjobave të policisë rrugore.⁵ Për më tepër, edhe pse shumica e shërbimeve të informacionit (niveli i parë) të hostuara në portalin e-Albania nuk kërkojnë regjistrimin, hulumtuesi MRP ka identifikuar disa raste kur shërbimet e tilla kërkojnë që përdoruesi të regjistrohet në portal (p.sh., informacionet mbi tarifatat dhe taksat vendore).⁶

A ISHTE E RËNDËSISHME?

1.3. Moduli i shpenzimeve publike në formatin e "të dhënave të hapura"

Disa aktorë sugjerojnë se zbatimi i këtij angazhimi, gjatë 2014-15 paraqet një hap modest për rritjen e transparencës së shpenzimeve të qeverisë. Shumica e aktorëve ngrenë shqetësime lidhur me cilësinë dhe përdorueshmërinë e informacionit të ofruar.

Pjesa më e madhe e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe gazetarëve të intervistuar nga hulumtuesi MRP kanë raportuar ose që nuk kishin informacion për këtë modul ose nuk e shihnin të dobishëm. Ata i konsiderojnë të dhënat për pagesat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave si mjet më i dobishëm⁷, që plotëson standardet me 2 vje të të dhënave të hapura,

sepse siguron akses tek të dhënat që shkarkohen në formatin Excel në lidhje me pagesat e përditshme të bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për vitet e 2014 dhe 2015. Të njëjtat të dhëna gjenden edhe në një format më të hapur në portalin e-Albania.⁸ Në mënyrë të veçantë, ky shërbim e-Albania përmbush standardin me 3 vje të të dhënave të hapura, sepse siguron akses të lirë (nuk ka nevojë për regjistrim) tek të dhënat që mund të printohen dhe shkarkohen në formatin XLS dhe CSV. Megjithatë, teksa lidhja në faqen e Thesarit ofron akses tek të dhënat për vitin 2014 dhe 2015, shërbimi e-Albania mbulon vetëm pagesat e përditshme të bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në vitin 2015.

Progres raporti i parë MRP ka sugjeruar se "publikimi i pagesave të bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në të ardhmen mund të jetë pjesë e Portalit të dhëna të hapura, në përputhje me standardet teknike për botimin e të dhënave dhe të ndërlidhura me funksionalitete tjera të portalit". Pak progres është bërë për të trajtuar këtë rekomandim.

Përveç agjencive të ndryshme qeveritare (p.sh., Instituti i Statistikave), edhe disa organizata të shoqërisë civile po ripërdorin tashmë dhe po publikojnë "të dhëna të hapura" me sukses të konsiderueshëm.⁹ Portali AIS për shpenzimet e hapura në vitin 2015 shënoi një mesatare prej 4,000 përdoruesish unikë në muaj dhe rreth 16,000 shikime në muaj në bazë të raporteve të paraqitura tek donatorët e portalit mes muajve maj dhe korrik 2015.¹⁰

3.3 e-Albania Portal

Ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi është mesatar. Portali ofron informacione të dobishme për jetën e përditshme të qytetarëve, siç janë dokumentet e nevojshme për marrjen e dokumenteve të identifikimit, patentën e makinës, regjistrimin e automjeteve, e kështu me radhë. Me më shumë investime në shërbimet publike dhe funksionin e tyre të interoperabilitetit, e kombinuar me ndërgjegjësimin e publikut për përdorimin e tij, portali mund të ketë ndikim të madh. Megjithatë, deri tani, përdorimi i portalit ka qenë modest. Vetë-vlerësimi i qeverisë ka raportuar në total "257 përdorime të këtij shërbimi gjatë muajit shtator 2015 në portalin e-Albania."

Fokus grupi i aktorëve të interesuar sugjeroi se e-Matura ka gjasa të jetë moduli më i përdorur i

e-Albania, sepse ky është i vetmi mjet për rreth 45,000 (në vitin 2015) nxënësve të shkollave të mesme që aplikojnë online për në universitetet publike. Po ashtu, janë ngritur shqetësime për cilësinë e shërbimeve dhe shtrirjes së tyre, për të cilën palët e interesuara sugjerojnë me forcë ndërmarrjen e një kontrolli të shërbimeve më shumë dhe më pak të përdorura të Portalit në mënyrë që të prioritizohen më mirë e-shërbimet dhe t'i përgjigjen më mirë nevojave të qytetarëve.¹¹

RRUGA PËRPARA

Hulumtuesi MRP sugjeron:

- Moduli duhet të rindërtohet për të përmbushur standardet e të dhënave të hapura. Një alternativë tjetër mund të ishte tërheqja nga ky angazhim dhe në vend të saj përqendrimi në portalin opendata.gov.al si dhe "publikimin e pagesave të bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit", në një format të të dhënave të hapur. Rekomandohet shumë bashkëpunimi dhe partneriteti me shoqërinë civile dhe grupet e interesit në këtë drejtim.
- MIAP dhe AKSHI, si dhe agjencitë e tjera qeveritare në nivel qendror dhe vendor që lidhin shërbimet e tyre me e-Albania, duhet të bëjnë më shumë për të promovuar portalin tek publiku në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve.
- Auditi i performancës së e-Albania do të ndihmonte institucionet përgjegjëse për të përmirësuar ndikimin dhe shtrirjen e tij, përfshirë këtu masat e posaçme që lidhen me gamën apo aksesin tek shërbimet.

¹ Progres Raport MRP për Shqipërinë 2011–13; "e-Albania", f. 72; "Publikimi i pagesave që bëhen përditë nga institucionet shtetërore" p. 78, të dyja janë marrë nga bit.ly/1ZgGdO1.

² Marrë nga bit.ly/1ONUE5h

³ Gjendet tek bit.ly/1ZUVBxi

⁴ Progres Raport MRP për Shqipërinë 2011-2013, p. 73, marrë nga bit.ly/1ZgGdO1

⁵ Faqja e Policisë së Shtetit marrë nga bit.ly/1TTldpG

⁶ Marrë nga bit.ly/1JIN0Zs

⁷ Gjendet tek bit.ly/1ngpFVf

⁸ e-Albania marrë nga at bit.ly/1N5QT5K

⁹ Të dhënat e hapura AIS marrë nga bit.ly/1TTIKba; Projekti i AIS i shpenzimeve të hapura gjendet tek bit.ly/1Zj3f1q

¹⁰ Intervistë me Drejtoren e AIS Aranita Brahaj, shtator 2015.

¹¹ Diskutimet e fokus grupit të aktorëve kryesorë 30 shtator 2015

GRUPI 3: AKSES I HAPUR PËR TË DHËNAT E BURIMEVE NATYRORE

Ky grup përbëhet nga dy angazhime, si më poshtë:

2.2 PORTALI ELEKTRONIK PËR ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN E BURIMEVE UJORE

Teksti i angazhimit:

Palët e interesuara që aplikojnë për licencë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore përballen me një procedurë të komplikuar dhe të gjatë të aplikimit. Mungesa e një inventari kombëtar të lejeve për shfrytëzimin e burimeve ujore është, po ashtu, një disavantazh që shkakton konflikte mes aktorëve institucionalë dhe palëve të interesuara. Ministria e Mjedisit, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore, do të ndërmarrë krijimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të ujit që do të përmirësojë bashkëpunimin mes aktorëve publikë dhe privatë

nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja për aplikimet e licencës dhe kontrollin.

Ky sistem do të ndihmojë në rritjen e transparencës në përdorimin e burimeve ujore në Shqipëri. Ky angazhim kërkon të përmirësojë qeverisjen e burimeve natyrore për një menaxhim më të mirë të ujit, duke ulur rastet e korrupsionit, forcimin e ndërgjegjësimit publik për menaxhimin e ujit. Krijimi i një regjistri online të përdoruesve të burimeve ujore do të ndikojë pozitivisht në transparencën dhe aksesin e publikut tek informacioni.

3.1 AKSESI ELEKTRONIK TEK ZONAT E MBROJTURA

Teksti i angazhimit:

Aksesi elektronik tek regjistri i zonave të mbrojtura rrit pjesëmarrjen dhe përfshirjen e opinionit publik dhe aktorëve të interesuar për aktivitetet që lidhen me zonat e mbrojtura, zonave të gjuetisë dhe nismave kombëtare legjislative në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Aksesi tek portal do të mundësojë konsultimin e dokumenteve ligjore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, një bazë të dhënash të zonave të reja të mbrojtura (ZM) ose zgjerimin e zonave ekzistuese, informacion mbi zonat e gjuetisë dhe hartat përkatëse dixhitale GIS. Krijimi i këtij portali do të kontribuojë fuqishëm në rritjen e transparencës

dhe pjesëmarrjes së publikut; në fakt, portal do të mundësojë shkëmbimin ndërveprues të mendimeve rreth projektligjeve, rregulloreve dhe strategjive në fushën e zonave të mbrojtura.

Shënim redaksional: Të dy angazhimet përqendrohen tek (aksesi tek) të dhënat në lidhje me burimet natyrore dhe zbatimin e tyre merret përsipër nga Ministria e Mjedisit.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Mjedisit

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
2.2 Portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore			X		X					X				X		
3.1 Aksesi Elektronik tek Zonat e Mbrojtura			X		X	X		X		X				X		

ÇFARË NDODHI?

Këto angazhime kanë për qëllim përmirësimin e transparencës në administrimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore, të tilla si zonat ujore dhe të mbrojtura në Shqipëri. Këto angazhime, të propozuara nga shoqëria civile, kanë për qëllim të publikojnë informacion mbi koncesionet për kompanitë private për përdorimin e burimeve natyrore (p.sh., lumenjtë), dhe kanë për qëllim të krijojnë një bazë të dhënash publike për zonat e ndotura, përfshirë edhe fushata informuese për të informuar qytetarët mbi pasojat e ndotjes në komunitetet e tyre.

Në kohën e konsultimit dhe miratimit të Planit të Veprimit (qershor 2014) Ministria e Mjedisit ka qenë në krye të sektorëve të synuar nga këto angazhime, përkatësisht të burimeve ujore dhe zonave të mbrojtura. Me një vendim të Këshillit të Ministrave në shkurt të vitit 2015 u transferua autoriteti mbi burimet ujore nga Ministria e Mjedisit tek Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.¹ Pika e kontakti PQH në këtë Ministri, tashmë përgjegjëse për angazhimin e "Portalit elektronik të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore", nuk i është bërë i njohur hulumtuesit MRP.

2.2. Portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (2012) përcakton krijimin e një portali të integruar të të dhënave elektronike ("Regjistri kombëtar i lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve").² Në kohën

e miratimit të Planit të Veprimit, u krijua dhe u botua në internet në formatin Excel në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit një bazë të dhënash (Regjistri Kombëtar) i autorizimeve të lëshuara për përdorimin e burimeve ujore.³ Portali për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore paraqet një sipërmarrje shumë më të plotë. Kjo ndërmarrje është pjesë e një projekti të asistencës kompleks zbatuar në Shqipëri nga Banka Botërore që nga maji 2013 në bashkëpunim me ministritë përkatëse dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.⁴ Projekti i ofron ndihmë Qeverisë së Shqipërisë për të hartuar strategjinë kombëtare të menaxhimit të integruar të ujit, zhvillimin e kadastrës ujit si dhe portalin elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore. Projekti ka pësuar ndryshime të mëdha për shkak të transferimit të autoritetit të menaxhimit të ujit nga Ministria e Mjedisit tek Ministria e Bujqësisë.⁵

Zhvillimi i strategjisë dhe kadastrës së ujërave është ende në proces. Portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore është në një fazë të hershme përgatitore, dhe përparimi i saj varet nga zhvillimi i kadastrës së ujit.⁶ Vetë-vlerësimi i qeverisë e raporton këtë angazhim si të pazbatuar.

3.1. Aksesi Elektronik tek Zonat e Mbrojtura

Ashtu si me angazhimin e mëparshëm, progresi për aksesin elektronik për zonat e mbrojtura ka qenë i kufizuar. Në kohën e publikimit të Planit të Veprimit PQH (korrik 2014), baza e dhënave për rrjetin e zonave të mbrojtura në Shqipëri ishte online në faqen e

Ministrisë së Mjedisit⁷ së bashku me një hartë të rrjetit të zonave të mbrojtura.⁸ Zhvillimi i këtij portali i është besuar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të cilat janë krijuar në shkurt të vitit 2015.⁹ Në bazë të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale “Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-20,”¹⁰ dhe sipas intervistave të MRP me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, portali do të zhvillohet me ndihmën e projektit të PNUD Shqipëri.¹¹

Përgatitjet për zhvillimin e portalit janë në një fazë të hershme. Harta GIS e zonave të mbrojtura gjendet tashmë tek Gjeoportali Kombëtar.¹² Portali “Aksesi Elektronik i Zonave të Mbrojtura” siguron informacion më të detajuar për çdo zonë të mbrojtur, përfshirë këtu edhe planet, aktivitetet, florën, faunën e kështu me radhë.¹³ Vetë- vlerësimi i Qeverisë sugjeron se ky angazhim është zbatuar pjesërisht, por nuk raporton për aktivitetet specifike të zbatuara, me përjashtim të “krijimit të formularëve për aksesin elektronik tek të dhënat për zonat e mbrojtura.” Siç sugjeron edhe përshkrimi i angazhimit, portali do të shërbejë edhe si kanal për konsultimin publik për dokumentet ligjore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Të dy angazhime janë shumë të rëndësishme për vlerat e PQH dhe janë në përputhje me rekomandimet e shoqërisë civile për të përmirësuar transparencën dhe për të hapur aksesin tek të dhënat e burimeve natyrore. Edhe pse përfaqësues të shoqërisë civile i konsiderojnë dy angazhime shumë të dobishme, fokus grupi theksoi se ndikimi i këtyre angazhimeve do të varet nga të tjera veprime. Portali elektronik i burimeve

ujore varet nga zhvillimi i një kadastrë të ujit, që nuk është finalizuar ende. Zhvillimi i mëtejshëm i portalit për zonat e mbrojtura varet nga asistenca e projektit të PNUD Shqipëri, i cili synon të përmirësojë efektivitetin e mbulimit dhe menaxhimit të rrjetit të Shqipërisë të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (projekti MCPA).

RRUGA PËRPARA

Duke marrë parasysh afatin kohor të projekteve që mbështesin zbatimin e këtyre angazhimeve (Banka Botërore dhe PNUD), hulumtuesi MRP sugjeron rishikimin e afatit për realizimin e këtyre angazhimeve në kuadër të Planit të Veprimit PQH. Edhe pse portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore do të vijë pas zhvillimit dhe miratimit të strategjisë kombëtare për menaxhimin e ujit, krijimi i aksesit elektronik tek zonat e mbrojtura do të kërkojë më shumë kohë për t’u zhvilluar plotësisht, për shkak të pasurisë së informacionit të planifikuar për të përfshirë në të.

¹ VKM nr. 91, 4 shkurt 2015 (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave); VKM nr. 92, 4 shkurt 2015 (Ministria e Mjedisit), Fletore Zyrtare nr. 16/2015, marrë nga bit.ly/1P0X9Dk

² Neni 4, pika 44 e Ligjit nr. 111/2012, 15 Dhjetor, 2012

³ Mund të shkarkohet nga bit.ly/1W7xVCN

⁴ VKM nr. 230, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave

⁵ “Ristrukturimi i projektit,” Banka Botërore, 23 prill 2014, marrë nga bit.ly/1P0XHJc

⁶ Intervista me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe me Eduart Cani, Qendra Rajonale e Mjedisit Tirana; shtator 2015

⁷ Marrë nga bit.ly/200oR4K

⁸ Marrë nga bit.ly/1UORbn6

⁹ VKM nr. 102, 4 shkurt, 2015, Fletore Zyrtare nr. 18/2015, marrë nga bit.ly/1TUU45Q

¹⁰ Plani i Veprimit, marrë nga bit.ly/1ZtROcy

¹¹ “Mbrojtja e Biodiversitetit Detar dhe Bregdetar të Shqipërisë,” faqja e PNUD Shqipëri, marrë nga bit.ly/1kQE2fX

¹² Marrë nga bit.ly/1mYDaJ8

¹³ Intervistë me Eduart Cani, Qendra Rajonale e Mjedisit (shtator 2015).

GRUPI 4: SHËRBIME TË THJESHTËSUARA DOGANORE

Ky grup përbëhet nga dy angazhime, si më poshtë:

2.3 SPORTELI UNIK

Teksti i angazhimit:

Për të lehtësuar dhe përsheptuar procedurat për tregti në sistemin doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të përqendrojë administrimin e kërkesave dhe procedurave nëpërmjet një sporteli të vetme (unik). Përdorimi i një sporteli unik do të zvogëlojë kohën e praktikave administrative, do të ulë koston dhe në mënyrë të pashmangshme do të rrisë nivelin e

transparencës. Ndërfaqja ndërmjet sektorit privat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave do të jetë një ndërfaqe web portal.

Bashkëpunimi institucional dhe koordinimi i veprimeve do të jetë në kohë reale. Sporteli unik do të rrisë nivelin e transparencës së transaksioneve ndërmjet administratës dhe sektorit privat.

3.4 E-DOKUMENTI

Teksti i angazhimit:

Formularët dhe dokumentet që duhet plotësuar për procedura të ndryshme në sistemin doganor nuk janë vetëm të komplikuar, por edhe të shumta. Në synimin për të lehtësuar aksesin në sistemin doganor do të prezantohet e-dokumenti (dokumenti elektronik). Jo vetëm që do të lehtësojmë përdorimin e formularëve dhe dokumenteve të ndryshme, por do të kontribuojmë edhe në krijimin e një mjedisi pa letra.

Ofrimi i shërbimeve publike në mënyrë elektronike përmes e-dokumenteve dhe e-formularëve do të lehtësojë procedurat për qytetarët dhe biznesin, duke ulur koston dhe kohën e përdorur për këtë shërbime. Kjo gjë do të përmirësojë edhe nivelin e aksesit tek informacioni për qytetarët duke i bërë procedurat më transparente. E-Dokumenti do të:

1. Përmirësojë aksesin e publikut duke i bërë dokumentet e zgjedhura, transparencën dhe informacionin e vlefshëm për qytetarët të disponueshme në internet.
2. Riorganizojë shërbime të qytetarëve duke u mundësuar të licencuarve të paraqesin dokumente elektronike me aplikimet e tyre online.
3. Rrisë efikasitetin duke eliminuar paraqitjen, marrjen dhe ri-dorëzimin e dokumenteve në letër, dhe duke ulur kohën e shpenzuar në kërkim për dokumentet e

humbura.

4. Ulë koston dhe rrëmujën e lidhur me proceset manuale me letra dhe shtypjen dhe arkivimin e të dhënave në letër.

5. Lejojë publikun të dorëzojë dokumente elektronike me formularët online për ankesat.

Shënim redaksional: Të dy angazhimet kanë për qëllim lehtësimin e aksesit tek shërbimet dhe sistemi doganor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për zbatimin e këtyre angazhimeve.

Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH				NDIKIMI I MUNDSHËM				ZBATIMI			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
2.3 Single Window			X		E PAQARTË					X				X		
2.4 E-document			X		E PAQARTË				X					X		

ÇFARË NDODHI?

Sporteli unik dhe e-Dokumenti në sistemin doganor synojnë përmirësimin e shërbimeve doganore për operatorët në sistemin e këmbimit tregtar të Shqipërisë, duke ulur kostot dhe lehtësuar procedurat si për operatorët ekonomikë ashtu edhe për administratën doganore. Të dy masat janë përfshirë në Planin e Veprimit, pas konsultimeve të brendshme me vetëm agjencitë qeveritare qendrore. Iniciativa e Sportelit Unik, duke përfshirë e-Dokumentin ishin nisur në mars të vitit 2014, në një konferencë të përbashkët për shtyp mes Kryeministrit të Shqipërisë, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Doganave.¹

Sipas një raporti publik të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, këto projekte ishin planifikuar të fillonin në vitin 2015.² Sipas procedurave të tanishme doganore, operatorët ekonomikë shqiptarë që janë të angazhuar në tregtinë me vendet e tjera duhet të mbledhin dhe paraqesin një sërë dokumentesh (p.sh., licenca, autorizime, certifikata) nga institucione të ndryshme në Shqipëri për mallrat që importojnë ose eksportojnë. Kjo procedurë është shumë e kushtueshme dhe kërkon kohë, jo vetëm për operatorët privatë, por edhe për administratën doganore që përpunon aplikimet. Sporteli unik do të sigurojë një sistem të ndërlidhur (rrjetin telematik) që u mundëson institucioneve shtetërore të komunikojnë dhe shkëmbejnë dokumentet (e- dokumenti). Sistemi do të mundësojë shkëmbimin e verifikuar dhe në kohë reale të dokumentacionit dhe procedurave.

Gjatë vitit të kaluar, është bërë progres shumë i kufizuar për të zbatuar këto angazhime, të cilat do të financohen nga buxheti i shtetit.³ Sa i përket Sportelit

Unik, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka ngritur një grup pune për të shtjelluar projektin, i cili është ende në fazën e hershme. Mund të ketë disa vonesa të mundshme, sepse Sporteli Unik kërkon investime të tjera në sistemin TIK të institucioneve të tjera shtetërore për të mundësuar interoperabilitetin.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të intervistuar nga hulumtuesi i MRP kanë raportuar se termat e referencës për tenderin e-Dokument janë përpunuar. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka për detyrë hapjen e procedurës së tenderit, e cila, në kohën e hartimit të raportit MRP, nuk ishte botuar ende.

A ISHTE E RËNDËSISHME?

Shoqatat e biznesit të intervistuar nga hulumtuesi MRP kanë shprehur optimizëm të lartë në përfitimet e sportelit unik dhe e-dokumentit. "Këto masa do të zëvendësojnë rolin tonë [operatorët ekonomikë] si "postier" që vrapojnë nga një institucion në tjetrin për të marrë dokumentet dhe t'ia paraqesin ato doganave."⁴

Lidhja PQH e këtyre angazhimeve është e paqartë. Përshkrimi i Planit të Veprimit për Sportelin Unik i referohet elementëve të transparencës dhe përgjegjshmërisë publike: "Përmirësojë aksesin e publikut duke i bërë dokumentet e zgjedhura, transparencën dhe informacionin e vlefshëm për qytetarët të disponueshme në internet" dhe "Lejojë publikun të dorëzojë dokumente elektronike me formularët online për ankesat." Megjithatë, intervistat MRP me institucionet përgjegjëse vunë në dukje

se sistemi ka vetëm dy bashkëbisedues- operatorët ekonomikë dhe institucionet shtetërore –dhe se nuk ka plane për lejjimin e aksesit të publikut tek ky informacion. Përfaqësuesit e sektorit të biznesit janë shumë skeptikë nëse aksesit i qytetarëve tek sporteli unik apo tek masat e tjera të transparencës publike do të jetë i mundur.

RRUGA PËRPARA

Edhe pse ka përfitime të qarta dhe të rëndësishme për të dy –për operatorët ekonomikë të angazhuar në tregtinë me vendet e huaja dhe për administratën shtetërore- mungesa e lidhjes PQH është e qartë. Si rrjedhojë, ky raport MRP sugjeron braktisjen e këtyre projekteve të rëndësishme për vendin si angazhim PQH. Një nga rekomandimet e shoqërisë civile gjatë konsultimit të PV në mars të vitit 2014 ishte që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të përpunonte dhe të publikonte një raport mujor mbi punën e administratës doganore duke bërë dallimin mes bizneseve dhe qytetarëve. Megjithatë, mbetet e paqartë se si kjo masë mund të mishërojë vlerat PQH.

V. PROCESI: VETË-VLERËSIMI

Qeveria shqiptare nuk e publikoi vetë-vlerësimin e vet në kohë.

Lista e kontrollit e vetë-vlerësimit

A u botua progres raporti vjetor?	<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
A u bë sipas afatit?	<input type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo
A është raport gati në gjuhë(t) administrative?	<input type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo
A është raport gati në anglisht?	<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
A la qeveria një periudhë dyjavore për komente nga publiku për draft raportin e vetë-vlerësimit?	<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
A u morën komente nga publiku?	<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
A është depozituar raporti tek portali PQH?	<input type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo
A u përfshi në raportin e vetë-vlerësimit shqyrtimi i përpjekjeve të konsultimit gjatë hartimit të planit të veprimit?	<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
A u përfshi në raportin e vetë-vlerësimit shqyrtimi i përpjekjeve të konsultimit gjatë zbatimit të planit të veprimit?	<input type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo
A u përfshi në raportin e vetë-vlerësimit ndonjë përshkrimi të periudhës së komenteve të publikut gjatë hartimit të vetë-vlerësimit?	<input type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo
A i mbuloi të gjitha angazhimet raporti?	<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
A vlerësoi përfundimin e secilit angazhim sipas kalendarit dhe objektivave në planin e veprimit?	<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo

PËRMBLEDHJE E INFORMACIONIT SHITESË

Vetë-vlerësimi i qeverisë u publikua më 13 tetor 2015 në faqen e Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP), inovacioni.gov.al. Raporti është në dispozicion vetëm në gjuhën angleze dhe i është dhënë një numri të kufizuar OSHC-ve përmes Koalicionit për PQH Shqipëri. Kjo qasje ngre shqetësime lidhur me mbulimin e tij jo vetëm në aspektin e shifrave por edhe për thellësinë e komenteve. Ka pasur edhe një periudhë dy-javore për komente nga publiku për vetë-vlerësimin. Deri në fund të tetorit 2015, Koordinatorin Kombëtar PQH ka marrë komente me shkrim për vetë-vlerësimin nga vetëm dy OShC. Në 20 tetor 2015 u mbajt një takim i përbashkët mes zyrtarëve të MIAP dhe përfaqësuesit të Koalicionit të OSHC-ve, ku u diskutuan për komentet dhe aspekte të ndryshme të vetë-vlerësimit. Koordinatorin Kombëtar PQH nuk i ka publikuar në internet këto komente apo procesverbalet e takimit me Koalicionin OSHC-ve.

CILËSIA E RAPORTIT TË VETË-VLERËSIMIT

Raporti i vetë-vlerësimit me njëzet e tre faqe ofron një vlerësim realist të procesit të PQH (konsultimi, zbatimimi dhe monitorimi i VP) dhe mësimet e nxjerra prej tij. Vetë-vlerësimi thekson se qeveria do të punojë me shoqërinë civile për të përmirësuar procesin dhe për të kërkuar mekanizma efikase për përfshirje më të gjerë dhe të vazhdueshëm të OSHC-ve.

Ky dokument thekson se institucionet shqiptare do të vazhdojnë të punojnë për zbatimin e të gjitha angazhimeve brenda afatit të Planit të Veprimit. Sipas vetë-vlerësimit, pjesa më e madhe e angazhimeve të Planit të Veprimit janë zbatuar plotësisht (6 nga 13) ose pjesërisht (3 nga 13). Për tre angazhime, po punohet ("në proces"), dhe një angazhim nuk është zbatuar.

Vetë-vlerësimi raporton për aktivitetet që janë kryer për të zbatuar angazhimin. Kuadri i përgjithshëm kohor i zbatimit të angazhimeve dhe niveli i detajimit të objektivave për çdo angazhim janë ende të paqarta. Vetë-vlerësimi nuk përfshin një përshkrim të shkallës së vlerësimit, kështu që mbetet mjaft e paqartë se çfarë nënkuptohet me "në proces" dhe "zbatuar pjesërisht".

Këto dobësi të vetë-vlerësimit rrjedhin nga projektimi

dhe struktura e Planit të Veprimit, i cili nuk shtjellon fazat e zbatimit të angazhimeve, afatit të tyre, ose të treguesve të ndikimit.

Në disa raste, vetë-vlerësimi jep disa informacione mbi rezultatet që kanë prodhuar disa angazhime: për shembull, numri i përdoruesve të shërbimit të "publikimit të pagesave të përditshme" (shtator 2015). Megjithatë, nuk ka të dhëna për ndikimin që ka ardhur nga rezultatet e arritura. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar lidhjen PQH të përpjekjeve të qeverisë dhe ndryshimeve (ndikim) që i përgjigjet pritshmërive të publikut.

TRAJTIMI I REKOMANDIMEVE TË MËPARSHME MRP

Vetë-vlerësimet kanë për qëllim të trajtojnë rekomandimet e mëparshme MRP. Në këtë pjesë rijepen rekomandimet kryesore dhe përshihen shënime për të evidentuar nëse këto rekomandime u trajtuan plotësisht, pjesërisht, ose nuk u trajtuan fare.

Nga 17 rekomandime konkrete nga Raporti MRP 2013 për procesin PQH dhe Planin e Veprimit, Shqipëria ka trajtuar plotësisht katër prej tyre, gjatë 2014-15. Nëntë rekomandime janë trajtuar pjesërisht dhe 4 rekomandime nuk janë trajtuar fare.

REKOMANDIMET E VITIT 2013

PROCESI GJITHËPËRFSHIRËS DHE KOMUNIKIMI

Procesi kishte një profil të ulët mes aktorëve kryesorë të shoqërisë dhe aktorëve shtetërorë përtej kryeqytetit dhe ka pasur një mungesë shikueshmërie gjatë dy viteve të fundit. Duke pasur parasysh defektet evidente dhe mangësitë gjatë fundit të vitit 2011 dhe fillim të vitit 2012, këto masa do të ndihmojnë në trajtimin e shqetësimeve të mëparshme me qëllim krijimin e agjendës PQH me kontekst specifik dhe të pranuar gjerësisht:

- Të identifikohen aktorët PQH shqiptarë dhe të lançohen aktivitete ndërgjegjësuese për këtë proces dhe për krijimin e rrjeteve të mbështetësve për procesin (**trajtuar pjesërisht**)
- Të hapet një fushatë informimi publik nëpërmjet

medias dhe mjeteve të tjera (përfshirë mekanizma e-pjesëmarrje) për të komunikuar platformën PQH Shqipëri dhe për të inkurajuar përfshirjen aktive dhe të vazhdueshme të qytetarëve **(trajtuar pjesërisht)**

- Të fillojë një fushatë e brendshme informuese për PQH dhe PQH në Shqipëri në të gjithë nivelet e administratës shtetërore, përfshirë institucionet qendrore qeveritare, agjencitë, autoritetet vendore dhe organet e mbikëqyrjes për të siguruar aktorë shtetërore të informuar dhe bashkëpunues.
- Të përqasen konsultimet e pritshme PQH për plan veprimin e ardhshëm nëpërmjet një vizioni afatmesëm për të ankoruar aktorët jo-shtetërorë në gjitha fazat e procesit si përgatitja e plan veprimit, konsultimi, zbatimi, vlerësimi dhe rishikimi. Qeveria duhet gjithashtu të përcaktojë kalendar të qartë për tu dhënë atyre kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për të marrë pjesë në diskutime **(trajtuar pjesërisht)**
- Të krijohet një strukturë e përhershme PQH (forum shumëpalësh) me shoqërinë civile, sektorin privat, median, akademinë, autoritetet vendore dhe aktorë të tjerë si pjesë e strukturës qeveritare institucionale që koordinon, monitoron dhe vlerëson në mënyrë aktive zbatimin e plan veprimit. **(i patrajtuar)**
- Të komunikohet dhe koordinohet me donatorët e përfshirë në procesin e reformave për të strukturuar më mirë asistencën zhvillimore afatmesme dhe marrëveshjet e asistencës shumë-dhe dypalëshe në përputhje me dokumentet kombëtare strategjike **(trajtuar pjesërisht)**
- Të shqyrtohen alternativa dhe mekanizma për të gjeneruar kontribute të vazhdueshme dhe për të përmirësuar kapacitetin absorbues dhe reagimin e agjendës PQH. **(trajtuar pjesërisht)**
- Përveç tre sfidave të para madhore PQH, të ndërmerren përgjegjësi dhe angazhime konkrete lidhur me dy sfidat e tjera (Krijimi i komuniteteve më të sigurta, dhe Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave) duke iu përgjigjur kështu shqetësimeve aktuale të sigurisë publike dhe thirrjeve të shoqërisë civile për mekanizma të qëndrueshëm në mbështetje të angazhimit

komunitar. **(trajtuar plotësisht)**

- Të nxitet një plan veprim i orientuar drejt rezultateve me një kuadër adekuat të indikatorëve të matshëm me kalendar të qartë dhe realist zbatimi. **(i patrajtuar)**

PARTNERITETE PËR ZBATIM, PRONËSI DHE PROCES TË NXËNI

Viti i parë i zbatimit të PQH Shqipëri u dominua ndjeshëm nga aktorët e qeverisjes qendrore me shumë pak sinergji të krijuara midis aktorëve të tjerë të mundshëm vendas. Komunikimi i thjeshtë i PQH si një nismë shumëpalëshe rrezikon të ofrojë një tjetër rast të përpjekjeve të imponuara nga jashtë dhe të varur nga donatorët nëse Qeveria dështon të ndajë pronësinë dhe të zhvillojë partneritete të qëndrueshme në nivel kombëtar. Në këtë kuptim, është thelbësore marrja parasysh e rekomandimeve të mëposhtme:

- Të mbështeten përpjekjet e shoqërisë civile, akademisë, autoriteteve vendore etj. në kuadër të principeve PQH, të shfrytëzohen praktikat më të mira, të promovohen rezultatet dhe të mbështeten përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm **(Trajtuar plotësisht)**
- Të ndajë përgjegjësi me dhe tu besojë aktorëve j o-shtetërorë zbatimin e fazave specifike të procesit PQH (bazuar në eksperiencën irlandeze) përfshirë bashkëpunimin dhe sinergjitë në kontekstin e zbatimit të angazhimeve konkrete **(Trajtuar plotësisht)**
- Të merren masa për përmirësimin e përfshirjes aktive të aktorëve shtetërorë në nivel rajonal dhe vendor, të përfshirë në ose që asistojnë zbatimin e angazhimeve specifike në partneritet me aktorët lokalë nga sektori civil dhe privat **(Trajtuar plotësisht)**
- Të nxitet komuniteti i donatorëve për të ndarë pronësinë dhe të mbështesë reforma relevante për PQH dhe objektivat zhvillimore në Shqipëri **(trajtuar pjesërisht)**
- Të nxitet për herë të parë ideja e krijimit të një forumi rajonal në Ballkan (perëndimor) me nën-forume të veçanta dhe të përbashkëta (aktorë shtetërorë e jo-shtetërorë) për ndarje

eksperiencash, asistencë të ndërsjelltë dhe shkëmbime. Të shqyrtohen mundësitë për angazhime rajonale për çështje dhe fusha me interes të përbashkët **(trajtuar plotësisht)**

- Të shfrytëzohet më shumë mekanizmi i të nxënit i PQH në nivel Qeveritar si edhe duke nxitur shkëmbime të shoqërisë civile dhe ndarje të eksperiencës në nivel kombëtar, rajonal dhe global **(trajtuar pjesërisht)**
- Të përqaset vlerësimi në nivel kombëtar nën një përjasje pjesëmarrëse dhe me një kalendar adekuat që lejon aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë të ofrojnë kontribut **(i patrajtuar)**
- Të harmonizohen ambiciet me nevojat dhe prioritetet e kontekstit vendor gjatë hartimit të plan veprimeve të ardhshme të cilat mbështeten në kontributin e aktorëve shoqërorë. **(trajtuar pjesërisht)**

¹ Marrë nga bit.ly/1Zuc5Pj

² Raporti 2014 për punën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, marrë nga bit.ly/1Q5yjkG

³ Intervistë me oficerin e kontaktit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, shtator 2015.

⁴ Intervistë me përfaqësuesin e Dhomës së Tregtisë Tiranë, shtator 2015.

VI. KONTEKSTI I VENDIT

Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat të Bashkimit Evropian në qersor 2014 dhe aktualisht vendi po zbaton reforma të mëdha për të hapur negociatat për anëtarësim në BE.

Karakterizuar si një “qeveri në tranzicion” ose “regjim hibrid”, vendi ka përmirësuar pikavarazhin e përgjithshëm të demokracisë në vitin 2015 (4.14) dhe ka nisur një sërë reformash në fushat e përgjegjshmërisë së qeverisë, transparencës dhe gjyqësorit, nxitur kryesisht nga procesi i anëtarësimit në BE. Në vitin 2015, vetëm një kolonë (qeverisja kombëtare demokratike) nga shtatë kolonat e indeksit të Freedom House u përmirësuan në vitin 2015, ndërsa nuk janë vënë re ndryshime në vlerësimin e vendit për proceset zgjedhore, shoqërisë civile, medias së pavarur, qeverisjes demokratike vendore, kuadrit të pavarësisë së gjyqësorit, si dhe korrupsionit.

Korrupsioni i përhapur mbetet një nga shqetësimet më të mëdha. Shqipëria renditet si një nga vendet më të korruptuara në Evropë, duke shënuar 33 nga 100 të Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International,¹ duke bërë që vendi të mbetet prapa të gjitha shteteve të tjera kandidate të BE-së. Qytetarët janë përballur shpesh me rryshfetin kur përdorin shërbimet publike. Shërbimet e perceptuara si më të ndjeshëm ndaj rryshfetit janë gjyqësori (81%), shëndetësia (80%), arsimit (70%), policia (58%) dhe shërbimet civile (52%).²

Qeveria e kryesuar nga Partia Socialiste, e cila erdhi në pushtet në vitin 2013, mori masa me synimin për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Këto masa përfshinin miratimin e ligjit të ri për shërbimin civil, miratimin e strategjisë kombëtare anti-korrupsion, si dhe forcimin e rregullave për deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesave të zyrtarëve publikë. Qeveria ka bërë përpjekje për të goditur korrupsionin edhe në arsimin e lartë me heqjen e licencave të 18 universiteteve të akuzuar për shitjen e diplomave.³

Korrupsioni politik ka qenë i përhapur dhe pak është bërë deri më tani për të trajtuar problemet kryesore

të saj. Fusha me interes të veçantë janë financimi i partive politike, mosndëshkimi de facto i zyrtarëve të nivelit të lartë, ndikimi i tepërt i interesave të biznesit privat në vendimmarrje politike dhe zbatimin e njëanshëm të shtetit ligjor nga ana e një gjyqësori joefektiv. Skandalet, të tilla si përdorimi i fondeve publike për të financuar media pro-qeveritare, e kanë justifikuar këtë dyshim dhe zbuluan lidhjet mes politikanëve dhe bizneseve të fuqishme, të cilat kanë qenë në gjendje për të përcaktuar agjendën politike.

Procesi i anëtarësimit në BE ka qenë një shtytës kryesor për reformat e zhvillimit dhe demokratizimit, veçanërisht në fushën e luftës kundër korrupsionit. Për të hapur bisedimet për anëtarësimin në BE, Shqipëria duhet të trajtojë pesë prioritetet kyçe: anti-korrupsioni, lufta kundër krimit të organizuar, reforma në administratën publike, reformën në gjyqësor dhe të drejtat e njeriut. Progres Raporti 2015 i Komisionit Evropian për Shqipërinë pranon “progres të mirë” në lidhje me reformën e administratës publike, por vë në dukje nevojën për masa të mëtejshme në katër fushat e tjera.⁴ Gjetjet kryesore dhe çështjet për veprime të mëtejshme sipas këtij raportit në pesë prioritetet përfshijnë:

1. Reformimi i gjyqësorit për të siguruar pavarësinë e tij
2. Zbatimin e vendimeve
3. Administrim më i shpejtë i drejtësisë
4. krijimi i dëshmive të qëndrueshme të hetimeve të korrupsionit në të gjitha nivelet dhe i ndëshkimeve të krimit të organizuar dhe pastrimit të parave; si dhe
5. zbatimin me efektivitet të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Përveç pesë prioritetëve kryesore të mësipërme, diskursi i politikave publike gjatë vitit të kaluar ka qenë i përqendruar gjithnjë e më shumë në përgjegjësinë e institucioneve, integritetin zgjedhor, financimin e partive politike, dekriminalizimin, dhe mjedisin mundësues për shoqërinë civile.

Shoqëria civile në Shqipëri ende ka një ndikim të

kufizuar në sferën publike. Dy pjesë të rëndësishme të legjislacionit, Ligji për të Drejtën e Informimit dhe Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin, të hartuar me kontribut nga OSHC-të dhe miratuar në vitin 2014, ka të ngjarë t'i japin një shtytje pozitive rritjes së pjesëmarrjes qytetare.

Arritje të tjera të rëndësishme që lidhen ngushtë me qeverisjen të hapur përfshijnë si vijon: miratimi i një Strategjie të re Kundër Korrupsionit dhe planin e saj për zbatim; Strategjia e Decentralizimit, përfshirë këtu ndarjen e re territoriale dhe administrative; Karta e Shoqërisë Civile; dhe krijimi i Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian si një forum me shumë aktorë të interesuar.

I ashtuquajturit debat i dekriminalizimit, që u zhvillua në vitin 2015, pas ekspozimit të anëtarëve të Parlamentit me rekorde të mëparshme kriminale, pritet të prodhojë legjislacion më të rreptë për të parandaluar persona të tillë që të zgjidhen apo të emërohen në poste publike. Megjithatë, këto masa ka të ngjarë të dështojnë në arritjen e rezultateve nëse vendi nuk ecën në drejtim të sfidave të tjera që lidhen me mosndëshkimin, financimin e partive politike, si dhe me reformën gjyqësore.

Edhe pse PQH ende nuk njihet mirë në Shqipëri, ai mund të përshpejtojë dhe të nxisë veprime të tjera për çështjet kritike të qeverisjes. Reformat e përshkruara më sipër janë të lidhura ngushtë me të katër vlerat PQH: aksesin tek informacioni, pjesëmarrja, përgjegjësia, dhe teknologjia për transparencë dhe llogaridhënie - dhe i bëjnë jehonë nevojës për vendimmarrje më të hapur dhe gjithëpërfshirëse publike.

Shqipëria është e angazhuar për të dhënë rezultate deri në fund të vitit 2015 për sa i përket reformës gjyqësore, miratimit të një ligji për mbrojtjen e informatorëve, dhe krijimin e një këshilli kombëtar për bashkëpunimin me shoqërinë civile. Ndërkohë, Shqipëria vazhdon të konsolidojë shërbimet publike nëpërmjet forcimit të administratës publike, përdorimit më të gjerë të teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

Zbatimi praktik i legjislacionit të miratuar mbetet një shqetësim në Shqipëri dhe organizatat e shoqërisë civile janë përqendruar në monitorimin

e instrumenteve dhe rregullave të prezantuara së fundmi, të tilla si aksesin tek informacioni dhe ligjet e konsultimit publik. Lufta kundër korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë, një nga pesë prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim me BE-në, mbetet një përparësi kryesore për shoqërinë civile, për donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë. Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të masave të qeverisë për të luftuar korrupsionin dhe për të përforcuar integritetin publik janë thelbësore për të arritur rezultate. Reforma zgjedhore dhe transparenca e financimit të partive politike kërkon fokus dhe përfshirje më të madhe, duke qenë se përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme në vitin 2017 po afrohen. Pavarësisht disa nismave për të promovuar transparencë në punën e organeve qeveritare, në një numër sektorësh, të dhënat e hapura në Shqipëri mbeten ende të pazhvilluara.

Këto zhvillime mund të japë një shtytje agjendës PQH në vend për të përfituar dhe për të kontribuar në diskursin e politikave dhe për të ndërmarrë veprimet përkatëse.

PRIORITETET E AKTORËVE KRYESORË

Plani aktual i veprimit dhe procesi PQH në Shqipëri

Pjesëmarrësit shprehën interes të lartë në përmbajtjen e planit të veprimit, teksa dhanë një opinion të përgjithshëm pozitiv mbi objektivat dhe ambiciet e pjesës më të madhe të angazhimeve. Lidhja e angazhimeve e-dokument dhe sportelit unik të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u vu në pyetje në diskutimet e fokus grupeve. Mungesa e vlerësimit të performancës dhe treguesve të monitorimit sipas aktorëve e bëjnë të vështirë ndjekjen e progresit dhe ndikimit të rezultateve.

Fokus grupet sugjeruan se cilësia e ndikimit (dhe jo sasisë së produkteve) dhe rezultatet e angazhimeve të PQH duhet të jenë kriteret kryesore për matjen e suksesit planit të veprimit. Duke tërhequr vëmendjen tek disa nga mjetet e denoncimit të korrupsionit në Shqipëri (p.sh., portal stopkorrupsionit.al ose aplikacioni Komisariati Dixhital), disa aktorë vunë në dukje nevojën për më shumë informacione për arritjet e tyre. "Nuk është numri i raporteve të paraqitura por rezultati i rasteve të denoncuar të korrupsionit

ato që duhet të drejtojnë këto mjete. Në mungesë të informacionit në lidhje me “çfarë ndodhi pas raportit të bërë dhe çfarë masash konkrete u morën”, publiku mund të humbasë interes dhe madje edhe të bëhet skeptik për këto mjete.” Disa nga përfundimet dhe rekomandimet kryesore për procesin PQH dhe Planin e tij të Veprimit gjatë 2014-15 në Shqipëri sipas grupeve të interesit në fokus grup janë si më poshtë:

- Proces i përmirësuar ndjeshëm i konsultimit për PV, në krahasim me Planin e Veprimit të parë (2012), nuk ishte ende në gjendje të arrinte audiencë më të gjerë jashtë kryeqytetit, duke përfshirë një nivel të ulët të informimit të administratës publike
- Nuk kishte asnjë përfshirje të shoqërisë civile në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit të veprimit. Koordinatorin PQH duhet të sigurojë transparencën e këtij procesi
- Përshkrimi i angazhimeve në PV nuk përfshijnë tregues të qartë për të vlerësuar progresin dhe ndikimin
- Shoqëria civile ka dështuar në përdorimin me kapacitet të plotë të agjendës PQH dhe të përshtatë rolin e saj të njohur në këtë proces

Angazhimet më të përshtatshme që kanë prodhuar rezultate apo që kanë potencial të madh për këtë gjë deri në fund të afatit të PV (2016) janë edhe të mëposhtmet:

- Standardizimi i ankesave kundër korrupsionit dhe portali stopkorrupsionit.al
- Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve
- Zyrat e shërbimit policor dhe aplikacioni i Komisarariatit Dixhital
- Gjeoportali kombëtar
- Databaza e të dhënave të qeverisë për asistencën ekonomike
- Krijimi regjistrave elektronikë në sektorë të ndryshëm (mjedis, industri)

Plani tjetër i veprimit PQH Shqipëri

Pjesëmarrësit e fokus grupit sugjeron se qeveria duhet të kryejë auditimin e ndikimit të angazhimeve të saj për të ndihmuar në hartimin e hapave të ardhshëm. Për shembull, në lidhje me Portalin

e-Albania, ndërmarrja e një kontrolli të shërbimeve më shumë dhe më pak të përdorura të Portalit do të ndihmonte institucionet të përmirësonin portalin dhe t'i përgjigjen më mirë nevojave të qytetarëve.

Këshillohet me forcë që t'i kushtohet më shumë fokus angazhimeve që synojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe përgjegjshmërinë publike. OSHC-të e intervistuar sugjeruan se, për shembull, Digital Albania ose përdorimi i mjeteve të tjera TIK për të përmirësuar qeverisjen, transparencën, llogaridhënien dhe shërbimet publike nuk do të sillnin rezultate pa “qytetarë aktivë” dhe mekanizmat e pjesëmarrjes.

Disa pjesëmarrës sugjerojnë fokus më të madh në reformat dhe nisma që synojnë grupe më të gjera dhe kategoritë në nevojë të qytetarëve, duke përfshirë komunitetin Rom, gratë dhe të rinjtë e papunë. Në këtë kontekst, baza e të dhënave e qeverisë për ndihmën ekonomike duhet të mbetet pjesë e Planit të Veprimit, edhe pse kjo është nisëm para-ekzistuese e mbështetur nga ndihma shumëvjeçare e donatorëve, dhe ndonëse ka disa shqetësime për lidhjen e saj me PQH.

Nevojitet koordinim më i mirë mes institucioneve qeveritare qendrore për hartimin e projekteve TIK ose aplikacioneve për të bashkëvepruar me publikun, për të shmangur “inflacionin e mjeteve të TIK” që nuk mund të krijojnë qytetarë aktivë.

Krijimi i një organi me shumë aktorë të interesuar për të mbikëqyrur zbatimin dhe vlerësimin e PQH do të përmirësonte mekanizmat për raportimin periodik dhe menaxhimin e rrezikut, dhe kjo do të nxiste përgjegjshmëri dhe llogaridhënie nga institucionet përgjegjëse. Kjo dhe rekomandime të tjera të patrajuara nga Progresi Raporti MRP 2013 për Shqipërinë duhet të marrë vëmendjen e merituar, duke përfshirë angazhimet specifike (p.sh., të financimit të partive politike), gjë që përputhet me zhvillimet aktuale politike në Shqipëri.

OBJEKTI I PLANIT TË PUNËS NË LIDHJE ME KONTEKSTIN KOMBËTAR

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është konsideruar si një prioritet kombëtar, i cili është në thelb inkuadron reformat dhe proceset

zhvillimore në sferat politike, ekonomike dhe të gjera shoqërore. Raporti i fundit i KE-së (nëntor 2015) arriti në përfundimin se "Shqipëria ka bërë përparim të qëndrueshëm për sa i përket kritereve politike", ndërsa thekson se për hapjen e negociatave për anëtarësim, vendit do t'i duhet të përfundojë "reformën gjithëpërfshirëse të sistemit gjyqësor." Raporti i KE-së po ashtu arriti në përfundimin se Shqipëria duhet të tregojë rezultate të mëtejshme të prekshme në fushën e shtetit ligjor "përfshirë progresin me qëllim krijimin e arritjeve të qëndrueshme në hetimet pro-aktive, ndjekjet penale dhe dënimet përfundimtare në të gjitha nivelet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar" "Dialogu politik ndërpartiak më konstruktiv si dhe përfshirja aktive e shoqërisë civile mbeten thelbësore për përparimin e mëtejshëm në lidhje me prioritetet e tjera për procesin e pranimit në BE."

Lufta kundër korrupsionit, përmirësimi i shërbimeve publike, nxitja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe përdorimi i teknologjive të informacionit për transparencë më të madhe, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë kanë qenë në qendër të të dy planeve të veprimit PQH në Shqipëri (2012 dhe 2014). Megjithatë, duke qenë se pjesa më e madhe e këtyre përpjekjeve janë përqendruar në hartimin e kuadrit ligjor, institucional, apo infrastrukturor, aktorë të shoqërisë civile i bëjnë jehonë rekomandimeve BE-së dhe vënë theksin në "krijimin e arritjeve dhe rezultate të prekshme."

Aktorët e intervistuar kanë theksuar prioritetet kryesore për hartimin e Planit të ardhshëm të Veprimit të Shqipërisë, të cilat janë si vijon: anti-korrupsioni, lufta kundër pandëshkueshmërisë, reformimi dhe monitorimi i gjyqësorit, përdorimi i TIK-ut dhe të dhënave të hapura për transparencë më të madhe, llogaridhënie dhe planifikim më të mirë të politikave, dhe mundësimi i një mjedisi për shoqërinë civile dhe pjesëmarrjen e publikut. Megjithatë, vëmendja duhet të zhvendoset në drejtim të angazhimeve të matshme dhe me lidhje me PQH, më ambicioze dhe specifike për të forcuar besimin e publikut në këto reforma.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, edhe pse shumica e pjesëmarrësve të fokus grupeve e kuptojnë gamën e gjerë të angazhimeve të mundshme që i përgjigjen vlerave PQH, të tilla si aksesimi në informacion, pjesëmarrja e qytetarëve apo përgjegjshmëria publike, ata inkurajojnë qeverinë të ndër marrë angazhime, të cilat të synojnë edhe komunitetet rurale dhe grupet e tjera të marginalizuara.

¹ Raporti 2014, marrë nga bit.ly/1JL7NeZ

² Barometri Global i Korrupsionit i Transparency International (2013). 3 Burimi <http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=albania>.

³ "Shqipëria mbyll 18 universitete që japin diploma false," faqja e ANSA, marrë nga bit.ly/1Rmahmy

⁴ Raporti i KE-së 2015 për Shqipërinë, marrë nga bit.ly/1GUJ5m

VII. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Rekomandime për të gjitha fushat

Të evidentohet ndikimi në terren: Shqipëria ka nevojë të ecë drejt masave më ambicioze dhe angazhimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe që përforcojnë besimin e tyre tek reformat dhe përgjegjshmëria e qeverisë. Në këtë kontekst, theksi mund të vihet në evidentimin e ndikimit dhe krijimin e një historie rezultatesh të prekshme dhe arritjeve që mishërojnë parimet bazë të transparencës, përgjegjshmërisë, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe përdorimit të teknologjisë dhe novacionit.

Qartësia e angazhimeve: Në hartimin e planit të mëtejshme të veprimit duhet të merren parasysh shqetësimet e ngritura për detajimin dhe matshmërinë

e tyre duke përcaktuar tregues realistë për nivelin e ndikimit dhe një afat të qartë kohor për arritjen e objektivave.

Zgjerimi i pjesëmarrjes: Për të arritur audienca më të mëdha, Plani i ardhshëm i Veprimit mund të zgjerohet dhe të përfshijë një spektër më të gjerë të institucioneve shtetërore nga të tre degët e saj: pushteti ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile, botën akademike, sektorin privat, dhe aktorë të tjerë. Mbeten ende të rëndësishëm një numër i konsiderueshëm rekomandimesh të Raportit MRP 2013 (faqet 88- 89¹), veçanërisht në lidhje me përmirësimin e zbatimit, pronësisë, komunikimin dhe të mësuarit nga procesi.

PESË REKOMANDIMET KRYESORE SMART

1. Të krijohet një forum i vazhdueshëm me pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe të hartohet një kuadër i plotë menaxhimi dhe raportimi (minimalisht me monitorim tremujor) për zbatimin e planit të veprimit.

2. Të ndërmerren angazhime më ambicioze të lidhura me PQH, të cilat i japin qytetarëve dhe grupeve të interesit një rol ndërveprues në fushat e anti- korrupsionit, luftës kundër pandëshkueshmërisë, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë. Qeveria mund të ofrojë më shumë mundësi për të orientuar kontributin e qytetarëve dhe monitorimin duke u bazuar në modelet e portaleve të denoncimit të korrupsionit dhe komisaritit dixhital.

3. Të promovohen përqasje të qeverisjes së hapur në zhvillimin e reformave dhe nismave kryesore sektoriale, përfshirë reformën në gjyqësor, financimin e partive politike, debatin e vazhdueshëm për integritetin e zyrtarëve publikë të zgjedhur dhe atyre të nivelit të lartë.

4. Shoqëria civile duhet të vlerësojë procesin PQH dhe të kanalizojë më mirë përmbajtjen e PQH në programin e saj.

5. Të caktohet një buxhet specifik dhe burime njerëzore për Koordinatorin Kombëtar, i cili merret me hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit PQH si dhe promovimin në nivel kombëtar të Agjendës PQH të Shqipërisë tek publiku, aktorët e interesuar, administrata publike dhe komuniteti i donatorëve.

¹ Progres Raport MRP 2011-2013 për Shqipërinë , gjendet tek adresa http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania%20OGP%20IRM%20Public%20Comment%20%28Eng%29_0.pdf

VIII. METODOLOGJIA DHE BURIMET

Si plotësim i vetë-vlerësimit të qeverisë, u përpilua një raport i pavarur vlerësimi MRP nga hulumtues të respektuar të qeverisjes, mundësisht nga secili vend pjesëmarrës në PQH.

Këta ekspertë përdorin një pyetësor dhe udhëzime raportimi të përbashkëta e të pavarura PQH¹, duke u bazuar te kombinimi i intervistave me aktorët vendorë PQH me punën analitike dhe kërkimore. Ky raport iu dha një paneli të vogël ekspertësh ndërkombëtarë (të caktuar nga Komiteti Drejtues PQH) për shqyrtim me qëllim që të sigurohej se janë zbatuar standardet më të larta të kërkimit dhe kujdesit të duhur.

Analiza e progresit për planet e veprimit PQH ndërthur intervistat, hulumtimin, dhe kontributin nga takimet me aktorët jo-qeveritarë. Raporti MRP bazohet në gjetjet e raportit të vetë-vlerësimit të qeverisë dhe vlerësime të tjera të progresit të hartuara nga shoqëria civile, sektori privat, apo organizatat ndërkombëtare.

Çdo hulumtues vendor kryen takime të palëve të interesuara për të siguruar një evidentim të saktë të ngjarjeve. Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore dhe kohore, MRP nuk mundi të konsultonte të gjitha palët e interesuara ose të prekura. Rrjedhimisht, MRP përpiqet për transparencë metodologjike dhe, për këtë arsye, kur është e mundur, bën publike procesin e angazhimit të palëve të interesuara në punën kërkimore (për të cilat jepen detaje më poshtë në këtë seksion.) Në ato kontekste kombëtare ku kërkohet anonimati i informatorëve-qeveritarë dhe jo-qeveritarë, MRP rezervon të drejtën për të mbrojtur anonimatit e informatorëve. Përveç kësaj, për shkak të kufizimeve të nevojshme të metodës, MRP inkurajon dhe mirëpret komente mbi draftet publike të çdo dokumenti kombëtar.

INTERVISTA DHE FOKUS GRUPE

Fokus grupe — Tiranë, 30 shtator 2015

ENë diskutimet në fokus grup të aktorëve kryesorë (30 shtator 2015) u trajtuan çështje të zbatimit dhe prioritetëve të PV për raundin e ardhshëm të procesit,

kryesisht nga perspektiva e lidhjes me vlera të PQH (në vend të sfidave të mëdha). Grupi mbledhi si aktorët e ndërgjegjësuar të PQH ashtu edhe ata që nuk ishin të ndërgjegjësuar nga shoqëria civile dhe komuniteti i donatorëve, që operojnë në sektorë e synuar nga Plani i Veprimit 2014-16, dhe fusha të tjera me potencial për zhvillimin e angazhimeve PQH. Në profilin e grupit përfshihet një raport i ekuilibruar gjinor. MRP kreu intervista të tjera (pas grupit të fokusit) me disa aktorë të sugjeruar nga diskutimet e fokus grupeve dhe (para grupit të fokusit) me palët e interesuara të biznesit dhe aktorët shtetërorë, të cilët nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në diskutimet e fokus grupeve.

Pjesëmarrësit e fokus grupit (30 shtator 2015)

- Aldo Merkoçi, Lëvizja MJAF!
- Dritan Ziu, Roma Active Albania
- Elona Dini, UNDP Albania
- Erisa Lame, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
- Klodian Seferaj, Fondacioni Shoqëria e Hapur Shqipëri – OSFA
- Klotilda Tavani, Partnerë Shqipëri
- Sabina Ymeri, Konsulente private e specializuar në vlerësimin e programeve të qeverisë dhe donatorëve të huaj
- Shefqet Shyti, Projekti i edukimit qytetar

Pjesëmarrësve të fokus grupeve iu dhanë paraprakisht shënime prezantuese dhe informacione për PQH, Planin e Veprimit 2014-16 të Shqipërisë dhe për procesin e konsultimeve në gjysmën e parë të vitit 2014. Pas hyrjes së shkurtër, diskutimi në fokus grup synoi kontekstin institucionale të planit të veprimit, modalitetet e zbatimit të tij, progresin e angazhimeve (rezultatet dhe ndikimi), dhe prioritetet për Planin e ardhshëm të Veprimit PQH.

Lista e të intervistuarve të Raportit MRP*

Adriatik Hasantari, Roma Active Albania

Aldo Merkoçi, Lëvizja MJAF!

Anisa Gjika, Zyra e Ministrit të Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike Aranita Brahaj, Instituti Shqiptar i Shkencave

Arben Dhima, Ministria e Energjetikës dhe Industrisë
Arben Nikshiqi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Arian Dyrmishi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Brunilda Paskali, Ministra e Ekonomisë, Zhvillimit, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Anëtarë të Stafit të Qendrës për Çështje të Informimit Publik

Edlira Nasi, Kryeministria

Eduart Cani, REC Albania

Elga Mitre, Ambasada Holandeze në Shqipëri

Eridana Cano, Zyra e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore

Erin Mlloja, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Erisa Cela, UN WOMEN Albania

Erisa Lame, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Erisa Proko, Zyra e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore

Ish përfaqësuesi i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë Jonida Cerekja, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Jonida Osmanlliu, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Juliana Hoxha, Partnerë Shqipëri

Klaudio Collaku, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Klodian Seferaj, Fondacioni Shoqëria e Hapur Shqipëri – OSFA

Loran Sevi, Ministria e Brendshme

Lorin Ymeri, Zyra e Ministrit të Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike Mirjam Reci, Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Naun Prifti, Ministra e Ekonomisë, Zhvillimit, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Renaldo Agolli, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit

Përfaqësuesi i INSTAT – Instituti i Statistikave

Përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave Përfaqësuesi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Sabina Ymeri, Konsulente Private

Shefqet Shyti, Projekti i Edukimit Qytetar

Zhaneta Prifti, Ministria e Mjedisit

*Pjesa më e madhe e intervistave janë realizuar midis muajve korrik dhe shtator 2015. Një numër i kufizuar intervistash u kryen midis qershorit 2014 dhe qershorit 2015 për të kuptuar më mirë synimin e angazhimit dhe qëllimin dhe kontekstin kombëtar. Nuk janë dhënë emrat dhe organizata të caktuara të intervistuar. MRP respekton aftësinë e individëve për të bërë komentet përkatëse në mënyrë anonime.

C. TË DHËNAT SIPAS SONDAZHIT

Sondazhit iu përgjigjën në total 15 të anketuar: shoqëri civile (9 të anketuar), administrata publike (3 të anketuar) dhe sektori privat (3 të anketuarve). Gati gjysma e tyre (7) ishin të informuar plotësisht ose në mënyrë të konsiderueshme në lidhje me PQH: disi të informuar ishin 3 të anketuar dhe shumë pak të informuar 4 të anketuar; nuk është të informuar aspak një i anketuar.

Burimi kryesor i informacionit për PQH ishte shoqëria civile për 9 të anketuar; 4 të tjerë ishin informuar nëpërmjet faqes MIAP ose Këshillit të Ministrave, ndërsa të tjerët theksuan median ose burime të tjera të informacionit.

Shumica e të anketuarve (8) ishin të informuar në lidhje me Planin e Veprimit PQH të Qeverisë. Katër të anketuar nuk kishin dëgjuar për të dhe tre të tjerë kishin shumë pak informacion.

Gjashtë të anketuar e konsideronin përmbajtjen e PV si tërësisht ose kryesisht të rëndësishëm për sfidat e vendit në fushën e qeverisjes së mirë. Pesë të anketuar thanë se kjo është pjesërisht ose jo shumë e rëndësishme dhe katër nuk kishin asnjë mendim në lidhje me këtë gjë.

Tetë të anketuar nuk kanë qenë të përfshirë në hartimin dhe konsultimet e planit të veprimit PQH. Pesë të anketuar raportuan se kishin qenë pjesë e konsultimeve të hapura me shoqërinë civile.

Disa nga sfidat dhe mangësitë e procesit të konsultimit sipas të anketuarve janë si më poshtë:

I paqartë roli i ekspertëve të përfshirë në hartimin e planit të veprimit

- Mungesa e një fushate informim me grupet e interesit dhe publikun
- Mungesa e konsultimeve jashtë kryeqytetit
- Mungesa e pranisë së temës PQH në media

- Mungesa e bashkëndimit me shoqërinë civile
- Mungesa e burimeve financiare
- Mungesa e vëmendjes së duhur nga shoqëria civile
- Mungesa e përfshirjes së aktorëve të tjerë (bota akademike, opinion bërësit, media, dhe aktorë të tjerë në sistemin e qeverisjes)

Të pyetur për **sfidat apo mangësitë gjatë zbatimit të planit të veprimit**, të anketuarit deklaruan si më poshtë:

- Mungesa e transparencës në monitorimin e zbatimit
- Mungesa e një forumi të përbashkët shoqëri civile-qeveri për të monitoruar zbatimin dhe për të zhvilluar kapacitetet
- Mungesa e procedurave të standardizuara dhe e një strategjie afatgjate
- Mungesa e burimeve financiare
- Angazhimet PQH nuk u shoqëruan me detaje të kostove të tyre financiare

Tre angazhimet më kryesore të planit aktual të veprimit për qeverinë e hapur në Shqipëri sipas të anketuarve janë si më poshtë:

- Zbatimi i modulit të shpenzimeve publike në formatin “të dhëna të hapura”(4 vota)
- Standardizimi i proceseve të ankesave që lidhen me korrupsionin (3 vota)
- Zyrat e shërbimit policor (3 vota)

Të pyetur posaçërisht për **tre angazhimet më kryesore që kanë pasur ndikimin më të madh dhe që kanë dhënë rezultate** gjatë 2014–15, pjesa më e madhe e të anketuarve sugjeruan të mëposhtmet:

- Standardizimi i proceseve të ankesave që lidhen me korrupsionin (stopkorrupsionit.al) (3 vota)
- Zyrat e shërbimit policor (3 vota)

Portali i anti-korrupsionit është një nga angazhimet për të cilat të anketuarit sugjerojnë vëmendjen të mëtejshme nga qeveria, së bashku me masat e mëposhtme për të përmirësuar qeverisjen, si Promovimi i PQH në nivel vendor; Përmirësimi i aksesit në informacion dhe Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; të dhënat e hapura dhe shpenzimet publike edhe në nivel vendor; Përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës në financimin e partive politike, përdorimin e burimeve publike kombëtare; Gjyqësori, etj.

Masat kryesore që do të përmirësojnë ndikimin e PQH në Shqipëri sipas të anketuarve janë si më poshtë: forcimi i rolit të shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin

e PV (10 të anketuar); përmirësimi i mekanizmave të monitorimit të zbatimit të PV (9 të anketuar); Fushatat e informimit publik (6 të anketuar); dhe fushata e informimit me punonjësit e institucioneve shtetërore (5 të anketuar). E fundit por jo më pak e rëndësishme, të anketuarit u pyetën se **në ç’masë ka prodhuar ndikim dhe rezultate në përmirësimin e qeverisjes në Shqipëri PQH**. Gjashtë prej tyre besonin se vetëm “në një masë të caktuar” dhe pesë të anketuar u shprehën “nuk e di”. Dy të anketuar besonin se PQH me siguri që ka prodhuar ndikim pozitiv, ndërsa dy të tjerë besonin se rezultatet kanë qenë shumë të kufizuara.

RRETH MEKANIZMIT TË RAPORTIMIT TË PAVARUR

MRP është një mjet kryesor me anë të të cilit qeveria, shoqëria civile dhe sektori privat mund të ndjekin hartimin dhe zbatimin nga qeveria të planeve të veprimit PQH çdo dy vjet. Hulimtimi dhe kontrolli i cilësisë së këtyre raporteve bëhet nga Paneli i Ekspertëve Ndërkombëtarë, të përbërë nga ekspertë të metodave të transparencës, pjesëmarrjes, përgjegjshmërisë dhe kërkimit në shkencat sociale.

Anëtarët e tanishëm të Panelit të Ekspertëve Ndërkombëtarë janë:

- Yamini Aiyar
- Debbie Budlender
- Hazel Feigenblatt
- Jonathan Fox
- Hille Hinsberg
- Anuradha Joshi
- Liliane Klaus
- Rosemary McGee
- Gerardo Munck
- Ernesto Velasco

Një staf i vogël në numër me qendër në Uashington DC kujdeset për raportet nëpërmjet procesit MRP në bashkëpunim të ngushtë me hulumtuesin. Pyetjet dhe komentet për këtë raport mund të drejtohen tek stafi në adresën irm@opengovpartnership.org

¹ Manuali i Procedurave MRP, marrë nga bit.ly/1rki45i

IX. SHTOJCA E PRANIMIT

Në shtator 2012, PQH vendosi të inkurajojë fuqimisht qeveritë pjesëmarrëse të miratonin angazhime ambicioze në lidhje me performancën e tyre për kriteret e pranimit në PQH. Njësia për Mbështetjen e PQH shqyrton kriteret e pranimit çdo vit. Këto rezultate paraqiten më poshtë. Aty ku është e përshtatshme, raportet MRP diskutojnë kontekstin në lidhje me përparimin apo hapat prapa për sa i përket kriterëve të caktuar në seksionin e kushteve të vendit.

Kërkesat për pranim: Për të marrë pjesë në PQH qeveritë duhet të demonstrojnë angazhim për qeverisjen e hapur duke plotësuar kriteret minimale në dimensionet bazë të qeverisjes së hapur. Tregues të hartuar nga palë të treta përdoren për të vlerësuar progresin e vendit në secilin prej dimensioneve. Për më shumë informacion vizitoni bit.ly/1929F11.

Kriteri	2011	Aktualis ht	Ndryshi mi	Shpjegimi
Transparenca e buxhetit ¹	4	4	Nuk ka ndryshim	4 = raporti i auditit dhe propozimi i buxhetit të ekzekutivit i publikuar 2 = Një prej të dyve i publikuar 0 = Asnjëri nuk është publikuar
Aksesi në Informacion ²	4	4	Nuk ka ndryshim	4 = Ligji për të drejtën e informimit 3 = dispozita kushtetuese për të drejtën e informimit 1 = Projekt ligj për të drejtën e informimit 0 = Nuk ka ligj për të drejtën e informimit
Deklarimi i pasurisë ³	4	4	Nuk ka ndryshim	4 = Ligji i deklarimit të pasurisë, të dhëna publike 2 = Ligji i deklarimit të pasurisë, të dhëna jo-publike 0 = Nuk ka ligj
Pjesëmarrja qytetare (pikët bazë)	3 (7.35) ⁴	3 (7.35) ⁵	Nuk ka ndryshim	Pikët bazë të Indeksit të Pjesëmarrjes së qytetarëve sipas EIU 1 > 0 2 > 2.5 3 > 5 4 > 7.5
Totali / (Përqindja) e mundshme	15/16 (94%)	15/16 (94%)	Nuk ka ndryshim	75% e pikëve të mundshme për t'u pranuar

¹ Për më shumë informacion shih tabelën 1 bit.ly/1Q6kx11. Për vlerësimet më të fundit shih bit.ly/1REJi6r

² Dy bazat e të dhënave të përdorura janë dispozitat kushtetuese në bit.ly/1InjKB dhe ligjet e projektligjet në bit.ly/1byKbT1

³ Simeon Djankov, Rafael La Porta, Florencio Lopez-de-Silanes, dhe Andrei Shleifer, "Disclosure by Politicians," (Tuck School of Business Working Paper 2009-60, 2009): bit.ly/19nDEfK; Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), "Llojet e informacionit që duhet të publikojnë zyrtarisht vendimmarrësit dhe niveli i transparencës," in Qeverisja në një vështrim 2009, (OECD, 2009). bit.ly/13vGtqS; Ricard Messick, "Deklarimi i të ardhurave dhe pasurive nga vendet klient të Bankës Botërore" (Washington, DC: World Bank, 2009). bit.ly/1clokyf; Për informacion më të fundit shih bit.ly/1hjHFEJ. In 2014, Komiteti Drejtues i PQH miratoi një ndryshim në masën e deklarimit të pasurive. Ekzistenca e ligjit dhe aksesit de facto i publikut tek të dhënat e deklaruara zëvendësojnë masat e deklarimit nga politikanët dhe nga zyrtarët e nivelit të lartë. Për më shumë informacion shih shënimin udhëzues në Kërkesat për Pranin në PQH për vitin 2014 në bit.ly/1EjLJ4Y

⁴ Njësia e Inteligjencës e Revistës Economist, "Indeksi i Demokracisë 2010: Demokracia në tërheqje" (Londër: Economist, 2010), marrë nga bit.ly/eLC1rE

⁵ Njësia e Inteligjencës e Revistës Economist, "Indeksi i Demokracisë 2014: Demokraciadhe pakënaqësitë e saj" (Londër: Economist, 2014), marrë nga bit.ly/18kEzCt



Independent Reporting Mechanism
Open Government Partnership
c/o OpenGovHub
1110 Vermont Ave NW Suite 500
Washington, DC 20005

Open
Government
Partnership

INDEPENDENT
REPORTING MECHANISM